

SHFK “Ibe Palikuqa” Bojanë-Saraj, Shkup

Raport për vetevaulimin e shkollës

2020-2021/2021-2022

FUSHA NR 1

TEMA : Planet dhe programet mësimore

Bojanë 2022

Fusha 1: PLANET DHE PROGRAMET MËSIMORE

Nr		Temat
1. 1	Realizimi i planeve dhe programeve arsimore	<ul style="list-style-type: none"> • Informimi i prindërve dhe nxënësve mbi planet dhe programet mësimore • Adaptimi i programeve mësimore për fëmijët me nevoja të veçaanta arsimore • Zgjedhja e lëndëve mësimore • Planifikimi i aktiviteteve për realizimin e orëve të lira/ aktiviteteve projektuese të shkollës • Realizimi i programeve të zgjeruara
1. 2	Cilësia e planeve dhe programeve arsimore	<p>Barazia gjinore dhe etnike dhe sensibiliteti multikulturor në programet mësimore dhe mjetet ndihmëse mësimore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Integrimi i karakteristikave dhe nevojave të mjedisit lokal në programet dhe mjetet ndihmëse mësimore • Integrimi i qëllimeve të përgjithshme (ndërmjet lëndëve) të arsimit • Ndikimi i mësimdhënësve, prindërve dhe partnerëve social në planet dhe programet mësimore
1. 3	Aktivitetet jashtëmësimore	<ul style="list-style-type: none"> • Vëllimi dhe llojlojshmëria e aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara jashtëmësimore • Përfshirja e nxënësve në aktivitetet jashtëmësimore • Inkuadrimi i nxënësve në zgjedhjen dhe planifikimin e punës gjatë aktiviteteve jashtëmësimore • Afirmimi i nxënësve dhe shkollës përmes aktiviteteve jashtëmësimore

Vetevaluimi i shkollës:

Fusha 1: Planet programore dhe mësimore

1.1. Realizimi i planeve dhe programeve mësimore
 Mbledhja e të dhënave (cilat të dhëna janë mbledhur: Cilat metoda janë shfrytëzuar)
 (1) Përpunimi i dokumenteve

Paraqitni të gjitha dokumentet që janë kontrolluar.	Cilat informata janë mbledhur?
<ul style="list-style-type: none"> • <u>Planet dhe programet mësimore të sjella nga MASH, të përpunuara nga Byroja e zhvillimit të arsimit</u> • <u>Programi vjetor për punën e shkollës</u> • <u>Planifikimet tematike të arsimtarëve</u> • <u>Procesverbalet nga Këshilli i prindërve</u> • Proçesverbalet nga këshilli i shkollës • <u>Dokumentacioni dhe evidence pedagogjike</u> • Ditarët e klasave 	<p>-Arsimtarët rregullisht i ndjekin seminarët dhe trajnimet që organizohen nga Biroja për zhvillimin e arsimit për realizimin e planeve dhe programeve mësimore</p> <p>-Planifikimet tematike vjetore të përgatitura nga ana e arsimtarëve lëndor dhe klasor janë në përputhshmëri me dokumentet e sjella nga MASH.</p> <p>-Procesi mësimor në shkollë realizohet në bazë të planeve dhe programeve mësimore të sjella nga MASH.</p> <p>-Shkolla i informon anëtarët e Këshillit të prindërve, por jo edhe prindërit tjerë për qëllimet e planeve dhe programeve mësimore që do të realizohen</p> <p>-Shkolla punon me nxënës me nevoja të veçanta arsimore që janë të kyçur në mësin e rregullt por jo edhe me programe mësimore të përshtatshme për disa pjesë të lëndëve .</p> <p>-Në shkollën tone nuk ju ofrohet nxënësve të bëjnë zgjedhje më shumë se (3) lëndëve mësimore sipas planit mësimor. Veprimi për zgjedhjen e lëndëve mësimore nuk zbatohet në mënyrë konsekuente.</p> <p>-Shkolla planifikon në programën vjetore aktivitete për orë të lira dhe të njejtat realizohen nëpërmjet sekcioneve të ndryshme nga arsimtarët lëndor me dy orë në javë.</p>

_Vetevaluimi i shkollës:

Fusha 1: Planet dhe programet mësimore

1.1. Realizimi i planeve dhe programeve mësimore		
Mbledhja e të dhënave (cilat metoda tjera janë shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave shemb. pyetësor, anketa, të vërejturit)		
Paraqitni metodat tjera që janë të shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave	Pjesmarrje: Cili ishte kyçur në mbledhjen e këtyre informacioneve	Cilat informata janë mbledhur?
-Pyetësor për arsimtarët	Ilirjana Murtezani Gjilfije Ziberi Xhevat Doko	<ul style="list-style-type: none"> • Arsimtarët e anketuar 8 (klasor) janë fituar këto rezultate: <ul style="list-style-type: none"> - Në pyetjen: Sa janë të informuar prindërit me qëllimet e planeve dhe programeve mësimore? • Janë të informuar - janë përgjigjur 2 ars. 25 % • Pjesërisht të informuar - janë përgjigjur 6 ars. 75 % • Nuk janë të informuar 0% -Në pyetjen: Sa janë të informuar prindërit me planet dhe programet mësimore, me cilat forma janë të informuar? <ul style="list-style-type: none"> • Njëpërmjet takimeve të prindërve - 50% • Njëpërmjet medimeve -25% • Njëpërmjet internetit - 25% <p>-Të gjithë arsimtarët e anketuar janë përgjigjur me po, kemi nevojë që plane dhe programet mësimore të adaptohen për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.</p> <p>-Në pyetjen: Në cilën mënyrë shkolla i informon anëtarët e Këshillit të prindërve, prindërit tjerë, nxënësit dhe të gjithë të tjerët që kërkojnë informacione për planet dhe programet mësimore që realizohen?</p> <p>Përgjigjja: Shkolla i shfrytëzon të gjitha mënyrat e mundshme që ti informon të gjitha subjektet:</p> <p>Anëtarët e Këshillit të prindërve, prindërit tjerë, nxënësit dhe të gjithë të tjerët që kërkojnë informacione për qëllimet planeve dhe programeve mësimore.</p>
Intervistë me drejtorin e shkollës: Bari Mamuti	Ilirjana Murtezani	

Vetevaluimi në shkollë :

Fusha 1: Planet dhe programet mësimore

1.2.Kualiteti i planeve dhe programeve mësimore Mbledhja e të dhënave (cilat të dhëna janë mbledhur: Cilat metoda janë shfrytëzuar) (1) Përpunimi i dokumenteve	
<u>Paraqitni të gjitha dokumentat që janë të kontrolluara</u>	Cilat informata janë mbledhur ?
<ul style="list-style-type: none">• <u>Planet dhe programet mësimore të sjella nga MASH, të përpunuara nga Byroja për zhvillim të arsimit</u>• <u>Programi vjetor për punë të shkollës</u>• <u>Procesverbalet nga Këshilli i prindërve</u>• Proçesverbalet nga këshilli i shkollës• <u>Plani dhe programi vjetor nga lënda e Biologjisë</u>• Plani dhe programi vjetor nga lënda e shoqërisë• <u>Plani dhe programi vjetor nga lënda e arsimit qytetar</u>• Ditarët klasor	<p>-Shkolla nëpërmjet këshillit të Arsimitarëve, Këshilli prindërve dhe këshilli i shkollës i shqyrton mendimet për cilësinë planeve dhe programeve mësimore nga ana e arsimtarëve dhe prindërve nga aspekti i barazisë gjinore dhe etnike.</p> <p>- Ekzistojnë shembuj për integrimin e veçorive dhe nevojave të rrethit lokal dhe mjetet ndihmëse mësimore në numër të vogël të programeve mësimore në mësimin lëndor, mirëpo e njëjta realizohet në shumë lëndë në mësimin klasor.</p> <p>-Gjatë realizimit të përmbajtjeve mësimore në lëndë të ndryshme ekziston mundësia e qasjes integrative të qëllimeve në mes lëndëve mësimore në programet klasore. Arsimitarët me përgjegjësi i realizojnë qëllimet në mes lëndëve</p> <p>-Shkolla organizon dhe realizon arsimim për prevenim të HIV/SIDA dhe varshmëritë nga droga nëpërmjet përmbajtjeve nga biologjia dhe nga ligjeratat profesionale prej mjekut.</p> <p>- Shkolla organizon dhe realizon arsimim për të drejtat e njeriut në mësimin klasor nëpërmjet përmbajtjeve nga lënda e shoqërisë në mësimin lëndor realizohet nëpërmjet përmbajtjeve të lëndës arsimimi qytetar.</p> <p>-Shkolla nuk ndërmarrë iniciativ për ndryshimin ose plotësimin e planeve dhe programeve mësimore dhe programe deri te MASH ose Byron e zhvillimit të arsimit, meqenëse ne nuk kemi patur ndikime as nga arsimtarët as nga</p>

prindërit.

Vetëevaluimi i shkollës

Fusha 1: Planet dhe programet mësimore

1.2.Kualiteti i planeve dhe programeve mësimore Mbledhja e të dhënave (cilat metoda tjera janë përdorur për mbledhjen e të dhënave shembull Pyetësor, anketa, të vërejturit.....)		
Shënoni metodat tjera që janë përdorur për mbledhjen e të dhënave	Pjesmarrje: Cili ishte kyçur në mbledhjen e këtyre informacioneve	Cilat informata janë mbledhur?
-Pyetësor për arsimtarët	Ilijana Murtezani Gjilfije Ziberi	-Të gjithë arsimtarët e anketuar janë përgjigjur se integrimi i qëllimeve të përgjithshme të arsimit ekziston mundësia e realizimit në mësimion klasor.
Intervistë me drejtorin e shkollës: Rafis Ameti	Ilijana Murtezani	Në pyetjen: A ka ndërmarr shkolla iniciativë për ndryshimin e planeve dhe programeve mësimore deri te MASH ose deri te Byroja e zhvillimit të arsimit? Përgjigjigje: Shkolla nuk ka ndërmarrë iniciativë për ndryshimin ose plotësimin e planeve dhe programeve mësimore deri te MASH ose Biroja e zhvillimit të arsimit sepse deri tani nuk kemi pasur ndikim as prej arsimtarëve as nga prindërit.

1.3. Aktivitete jo mësimore	
Mbledhja e të dhënave (Cilat të dhëna janë mbledhur) (1) Përpunimi i të dhënave	
<u>Shënoni të gjitha dokumentet që janë kontrolluar.</u>	<u>Cilat informata janë mbledhur?</u>
<ul style="list-style-type: none"> • Programi vjetor për punën e shkollës • Raporti vjetor për punën e shkollës • Rezultatet nga pjesmarrja në garat e diturisë • Rezultatet nga pjesmarrja në garat sportive • Diplomat, mirënjohje dhe lavdata nga pjesmarrja në gara dhe aksione • Raporti përfundimtar për punën e organizatës së Kryqit të Kuq • Prezentimi i projektit 	<p>-Shkolla planifikon në programin vjetor dhe realizon aktivitete jashtëmësimore të ndryshme, programe kulturore-artistike, aktivitete projektuese, aksione dhe ekskurzione të nxënësve.</p> <p>-Në shkollë një numri të madh të nxënësve u jepet mundësi të kyçen në aktivitete të ndryshme jashtëmësimore të ndryshme për përkrahjen e zhvillimit personal në mënyrë të barabartë të arritshme edhe për nxënësit meshkuj dhe femra, përfaqësimi etnik dhe prejardhja sociale.</p> <p>- Shkolla pjesërisht siguron kushte për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore për kyçjen aktive në aktivitete jashtëmësimore.</p> <p>-Kyqja e nxënësve në aktivitete jashtëmësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për shkak të pandemisë Kovid-19 shumë aktivitete brenda shkollore dhe jashtashkollore nuk janë mbajtur gjegjësisht janë anuluar. • Shkolla jonë ka organizuar puntori online me shkollën partnere “Petar Pop-Arsovski” në lidhje me multikulturarizmin dhe njohjen reciproke të kulturave të të dy komuniteteve. • Nxënësit punuan dy proekte në tema: „Kultura dhe folklori i maqedonasve,, dhe „Dita e verës,,. <p>- Në garat e diturisë që mbahen në nivel të shkollës marrin pjesë nxënësit</p>

	<p>prek klasave III deri klasa e IX.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rezultatet nga garat shkollore ishin si vijon: <ol style="list-style-type: none"> 1.Eanda Memedi IX-2 2.Mirnesa Rexhepi VIII-1 3.Erda Murati IX-2 - Nxënësit prej klasës së I deri të klasës VIII ishin aktiv në projektin shkollor – aksioni „Dekorimi i klasave,, - në ditën e Ekologjisë – 21 Mars. - Nxënësit motivohen dhe përmbahen , dhe ju jepet ndihmë nga ana e shkollës dhe nga arsimtarët për realizimin e aktiviteteve jashtëmësimore. - Nxënësit kyçen në aktivitete të ndryshme jashtëmësimore, punojnë në proekte, marrin pjesë në gara që organizohen në nivel të shkollës, lokale dhe në nivel nacional dhe tentohet që të arrihen rezultate të larta. Mirëpo në shkollë nuk ka kushte hapsinore as mjete financiare për afirmimin e aktiviteteve jashtëmësimore. (shembull: gazet shkollore, radio etj.)
--	---

1.3. Aktivitete jashtëmësimore		
Mbledhja e të dhënave (cilat metoda tjera janë përdorur për mbledhjen e të dhënave shembull: pyetsor, anketa, të vërejturit..)		
Shënoni metodat tjera që janë përdorur për mbledhjen e të dhënave	Pjesmarrje: Cili ishte kyçur në mbledhjen e informatave	Cilat informata janë mbledhur?
<p>-Pyetsor për arsimtar</p> <p>-Pyetsor për nxënës</p> <p>-Të vërejturit e nxënësve</p>	<p>Komisioni prej 5 anëtarëve:</p>	<p>-Të gjithë arsimtarët dhe nxënësit e anketuar janë deklaruar se në shkollë realizohen aktivitete jashtëmësimore, dhe të njëjtat i kanë në disponim nga të dy gjinitë.</p> <p>-Në pyetjen: Cilat janë dobitë e aktiviteteve jashtëmësimore?</p> <p>Arsimtarët janë përgjigjur: Nxënësit i thellojnë dhe i zgjerojnë dituritë, plotësimi i nevojave dhe interesave të tyre, zmadhimi i motivimit të tyre për pjesmarrje aktive në jetën dhe punën e shkollës para bashkësisë lokale dhe më të gjerë nëpërmjet punimeve personale dhe tej.</p> <p>- Sipas arsimtarëve dhe nxënësve të anketuar kemi marrë përgjigje se nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nuk kanë mundësi të kyçen në aktivitete jashtëmësimore.</p> <p>- Sipas të vërejturit e mësojtoreve nga ana e komisionit shkollor u konstatua se aksioni nga ana e nxënësve ishte i suksesshëm dhe të gjitha klasave i'u ndanë lavdata .</p>

Rezultatet: shpalosje e anëve kyçe të forta dhe të dobëta

Anët e forta vendimtare

- Ndjekje e rregullt e seminareve dhe trajnimeve nga ana e arsimtarëve për planet dhe programet mësimore.
- Rregullisht arsimtarët përgatisin planifikime tematike-vjetore nga ana e arsimtarëve klasore dhe lëndor.
- Aktivitetet për orët e lira realizohen nëpërmjet sekcioneve të ndryshme.
- Shkolla realizon arsimim për të drejtat e njeriut në mësimin klasor nëpërmjet lëndës së shoqëris dhe në mësimin lëndor arsimimi qytetar.
- Shkolla realizon aktivitete jashtëmësimore, aktivitete proektuese, aksione për ekskurzionet e nxënësve.
- Nxënësit kyçen në aktivitete jashtëmësimore në mënyrë të barabartë edhe gjinia femrore edhe mashkullore, përfaqësimi etnik dhe prejardhja sociale.

Antarët e timit:

1. Ilirjana Murtezani-Psikologe
2. Gjilfije Ziberi –Pedagoge
3. Xhevat Doko – Ars.i Matematikës

Fusha nr.2: Arritjet e nxënësve	
<p>Nr. Treguesi i cilësisë</p> <p>2.1 Arritjet e nxënësve</p>	<p style="text-align: center;">Temat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja dhe arritja e nxënësve të gjinive, përkatësisë etnike sipas lëndëve mësimore, sipas periudhave kualifikuese dhe gjuhës mësimore • Përmirësimi i arritjes së nxënësve me përkatësi të ndryshme gjinore, etnike dhe gjuhës mësimore • Identifikimi i nxënësve që kanë vështirësi në mësim, nxënësve me talent të veçantë dhe atyre me nevoja të veçanta mësimore • Përmirësimi i arritjes së nxënësve përmes mësimit plotësues • Ndjekja e arritjeve të nxënësve të rregullt dhe të çrregullt gjatë kalimit nga një cikël në tjetrin dhe nga një nivel arsimorë në një tjetër • Ndjekja e lëvizjes horizontale dhe vertikale të nxënësve
<p>2.2 Mbajtja / shpërndarja e nxënësve</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja e nxënësve • Rregullshmëria në mësim • Shpërndarja e nxënësve • Kalimi i nxënësve prej një shkolle në një tjetër
<p>2.3 Përsëritja e nxënësve</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit që nuk e mbarojnë klasën

FUSHA NR.2: Arritjet e nxënësve

<p>2.1 Arritjet e nxënësve</p>	
<p>Tema:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja dhe arritja e nxënësve të gjinive, përkatësisë etnike sipas lëndëve mësimore, sipas periudhave kualifikuese dhe gjuhës mësimore • Përmirësimi i arritjes së nxënësve me përkatësi të ndryshme gjinore, etnike dhe gjuhës mësimore • Identifikimi i nxënësve që kanë vështirësi në mësim, nxënësve me talent të veçantë dhe atyre me nevoja të veçanta mësimore • Përmirësimi i arritjes së nxënësve përmes mësimi plotësues • Ndjekja e arritjeve të nxënësve të rregullt dhe të çrregullt gjatë kalimit nga një cikël në tjetrin dhe nga një nivel arsimorë në një tjetër • Ndjekja e lëvizjes horizontale dhe vertikale të nxënësve 	<p>Përdorimi i programeve mësimore, seminarët e ndryshme si dhe zbatimi i metodave dhe teknikave të reja në procesin edukativo-asimor, ndikojnë në përmirësimin e arritjeve të nxënësve.</p> <p>Në shkollën tonë, nga ana e drejtorit dhe psikologes të shkollës, arsimtarëve iu janë dhënë udhëzime, konsultime profesionale me qëllim të organizimit sa më të mirë të procesit mësimorë dhe arritjes së rezultateve më të mira të nxënësve.</p> <p>Shkolla ndjek arritjet e nxënësve të gjinive, përkatësisë etnike sipas lëndëve mësimore, sipas periudhave kualifikuese dhe gjuhës mësimore.</p> <p>Nga raporti statistikor për fund të vitit shkollor 2017/2018, shohim se nga gjithsej 508 nxënës, 167 nxënës ishin të notuar me shkrim, kurse 341 ishin me nota pozitive , edhe atë : të shkëlqyeshëm ishin 102 nxënës, Shumë mirë ishin 72 nxënës, Mirë ishin 93 nxënës, Mjaftueshëm ishin 52 nxënës.</p> <p>Nota mesatare në shkollën qendrore të f. Bojanë është si vijon : Nga klasa e I deri në klasë të III nxënësit janë notuar me shkrim dhe komunikim gojorë.</p> <p>Në grupin klasorë kl.IV-V nota mesatare është 3,66. Në grupin lëndor nga klasa VI-IX nota mesatare është 3,73. Suksesi I përgjithsh për vitin shkollor 2017/18 në shkollën qendrore të f. Bojanë është 3,69.</p> <p>Nota mesatare në shkollën periferike të f. Llaskarcë është si vijon : Nga klasa e I deri në klasë të III nxënësit janë notuar me shkrim dhe komunikim gojorë.</p> <p>Në grupin klasorë kl.IV-V nota mesatare është 3,67. Në grupin lëndor nga klasa VI-IX nota mesatare është 3,19. Suksesi I përgjithsh për vitin shkollor 2017/18 në shkollën periferike të f. Llaskarcë është 3,43.</p> <p>Nota mesatare në shkollën periferike të f. Paniçarë është si vijon : Nga klasa e I deri në klasë të III nxënësit janë notuar me shkrim dhe komunikim gojorë.</p> <p>Në grupin klasorë kl.IV-V nota mesatare është 3,65. Në grupin lëndor nga klasa VI-IX nota mesatare është 3,83. Suksesi I përgjithsh për vitin shkollor 2017/18 në shkollën periferike të f. Paniçarë është 3,67.</p>
	<p>Nota mesatare në niveë të shkollës është 3.4.</p> <p>Në Sh.F.K “ Ibe Palikuqa” Bojanë,Saraj-Shkup, nota më e lartë me mesatare më të lartë është në shkollën qendrore f. Bojanë 3.69.</p> <p>Nga raporti statistikor për fund të vitit shkollor 2018/2019,</p>

shohim se nga gjithsej 506 nxënës, 176 nxënës ishin të notuar me shkrim, kurse 330 ishin me nota pozitive , edhe atë : të shkëlqyeshëm ishin 150 nxënës, Shumë mirë ishin 72 nxënës, Mirë ishin 78 nxënës, Mjaftueshëm ishin 36 nxënës.

Nota mesatare në shkollën qendrore të f. Bojanë është si vijon : Nga klasa e I deri në klasë të III nxënësit janë notuar me shkrim dhe komunikim gojorë.

Në grupin klasorë kl.IV-V nota mesatare është 3.93.

Në grupin lëndor nga klasa VI-IX nota mesatare është 3,91.

Suksesi I përgjithsh për vitin shkollor 2018/19 në shkollën qendrore të f. Bojanë është 3,92.

Nota mesatare në shkollën periferike të f. Llaskarcë është si vijon : Nga klasa e I deri në klasë të III nxënësit janë notuar me shkrim dhe komunikim gojorë.

Në grupin klasorë kl.IV-V nota mesatare është 4.01.

Në grupin lëndor nga klasa VI-IX nota mesatare është 3.70.

Suksesi I përgjithsh për vitin shkollor 2018/19 në shkollën periferike të f. Llaskarcë është 3,85.

Nota mesatare në shkollën periferike të f. Paniçarë është si vijon : Nga klasa e I deri në klasë të III nxënësit janë notuar me shkrim dhe komunikim gojorë.

Në grupin klasorë kl.IV-V nota mesatare është 3.76.

Në grupin lëndor nga klasa VI-IX nota mesatare është 3,49.

Suksesi I përgjithsh për vitin shkollor 2018/19 në shkollën periferike të f. Paniçarë është 3,62.

Nota mesatare në niveë të shkollës është 3.92.

Në Sh.F.K “ Ibe Palikuqa” Bojanë,Saraj-Shkup, nota më e lartë me mesatare më të lartë është në shkollën qendrore f. Bojanë 3.92.

Nga raporti statistikor për gjysëmvetori i parë për vitin shkollor **2019/2020**, shohim se nga gjithsej 516 nxënës, 165 nxënës ishin të notuar me shkrim, kurse 327 ishin me nota pozitive , edhe atë : të shkëlqyeshëm ishin 117 nxënës, Shumë mirë ishin 80 nxënës, Mirë ishin 88 nxënës, Mjaftueshëm ishin 42 nxënës.

Nota mesatare në shkollën qendrore të f. Bojanë është si vijon : Nga klasa e I deri në klasë të III nxënësit janë notuar me shkrim dhe komunikim gojorë.

Në grupin klasorë kl.IV-V nota mesatare është 3.85.

Në grupin lëndor nga klasa VI-IX nota mesatare është 3,59.

Suksesi I përgjithsh për vitin shkollor 2019/20 në shkollën qendrore të f. Bojanë është 3,72.

Nota mesatare në shkollën periferike të f. Llaskarcë është si vijon : Nga klasa e I deri në klasë të III nxënësit janë notuar me shkrim dhe komunikim gojorë.

Në grupin klasorë kl.IV-V nota mesatare është 3.67.
Në grupin lëndor nga klasa VI-IX nota mesatare është 3.73.
Suksesi I përgjdhsh për vitin shkollor 2019/20 në shkollën periferike të f. Laskarcë është 3,70.

Nota mesatare në shkollën periferike të f. Paniçarë është si vijon : Nga klasa e I deri në klasë të III nxënësit janë notuar me shkrim dhe komunikim gojorë.

Në grupin klasorë kl.IV-V nota mesatare është 3.75.
Në grupin lëndor nga klasa VI-IX nota mesatare është 3,18.
Suksesi I përgjdhsh për vitin shkollor 2019/20 në shkollën periferike të f. Paniçarë është 3,51.

Nota mesatare në niveë të shkollës është 3.64.

Në Sh.F.K “ Ibe Palikuqa” Bojanë,Saraj-Shkup, nota më e lartë me mesatare më të lartë është në shkollën qendrore f. Bojanë (3,72).

Gjatë vitit shkollor 2017/2018, shkolla jonë morri pjesë në Olimpiadën shkollore 2018-Saraj, ku me gjithsej 40 pikë ose 9 medalje, ishte fituese e Olimpiadës shkollore 2018-Saraj.

Në futboll u rendit në vendin e dytë,
në volejbol morri vendin e parë,
në kërcim (meshkujt) morri vendin e parë,
vrapim (vajzat) – klasa e VI – vendi i parë,
vrapim (vajzat)- klasa e VIII-nëntëvjeçare – vendi i dytë, vrapim (vajzat) - klasa e VIII-tetëvjeçare – vendi i tretë,
vrapim (meshkujt)-klasa e VI –vendi i dytë,
vrapim (meshkujt)-klasa e VIII-nëntëvjeçare – vendi i tretë dhe vrapim (meshkujt) -klasa e VIII-tetëvjeçare – vendi i parë.

Në garat e diturisë me gjithsej 4 pikë dhe 1 medalje, klasa e VI fitoi 74 pikë, klasa e VII – 42 pikë, klasa e VIII nëntëvjeçare fitoi 61 pikë dhe klasa e IX – 53 pikë. Domethënë me gjithsej 230 pikë, shkolla jonë u rendit në vendin e katërt.

Shkolla bën identifikimin e nxënësve që kanë vështirësi në mësim, nxënësve me talent të veçantë dhe atyre me nevoja të veçanta mësimore,Është përpiluar programi për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore në të cilin janë të përfshira qëllimet, përmbajtja, realizuesit dhe koha e realizimit.

Për nxënësit të cilët kanë vështirësi në mësim, gjatë vitit shkollor organizohet mësim plotësues. Nga ato lëndë në të cilët do të evidentohen më shumë nota negative , ose nxënësit që tregojnë sukses më të dobët, arsimtarët obligohen që të realizojnë mësim plotësues.

Paniçarë			1	1	1				
----------	--	--	---	---	---	--	--	--	--

Pasqyra e nxënësve që janë çregjistruar viti 2018/1019

Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Bojanë									
Llasakrcë									
Paniçarë				1		1		1	1

Pasqyra e nxënësve që janë çregjistruar viti 2019/2020

Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Bojanë	2	3	3	2		1			
Llasakrcë									
Paniçarë									

Burimet e të dhënave

Programi për punë të shkollës, raportet shkollore, listat e nxënësve, analizat e përfshierjes dhe ungesës nga mësimi, bisedat me drejtorin dhe organet profesionale, ditarët e klasave, qasja në evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik, etj.

<p>2.3 Përsëritja e nxënësve</p>	
<p>Temat:</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësit që nuk e mbarojnë klasën 	<p>Të gjithë nxënësit e shkollës e kryejnë vitin shkollor. Në fund të vitit shkollor 2018/2019</p> <p>të gjithë nxënësit e shkollës e mbaruan vitin shkollor.</p> <p>Kontrollimi dhe vlerësimi i të arriturave të nxënësve janë aktivitete të rëndësishme në procesin mësimor, me të cilët fitohen informata për përparimin e nxënësve në bazë të cilave identifikohen problemet dhe vështirësitë si dhe planifikohen masa për kalimin dhe përmirësimin e tyre në procesin mësimor.</p> <p>Sipas taksonomisë së Blumit çdo nxënës ka njohje të veçanta (aftësi që nxënësit të kujtohen dhe të prodhojnë informata të veçanta dhe të izoluar). Kanë njohje të terminologjisë dhe njohje të fakteve specifike (njohje të datave, fakteve, ngjarjeve, vendeve etj). Me njohjen mendohet për mundësinë që nxënësi të kujtohet dhe të tregojë fakte të veçanta si dhe nocione të përgjithshme. Domethanë sipas taksonomisë së Blumit nuk është e mundur përsëritja e nxënësve pasi që çdo nxënës është i aftë të kujtohet në informata të veçanta.</p>
<p>Burimet e të dhënave</p>	
<p>Analizat për suksesin e nxënësve gjatë tri viteve të kaluara, qasja në dokumentacionin pedagogjik, bisedat me nxënësit, prindërit dhe me shërbimet profesionale, etj</p>	

Anët pozitive dhe negative të fushës nr.:2 Arritjet e nxënësve

Anët pozitive	<ul style="list-style-type: none">• Shkolla rregullisht ndjek arritjet e nxënësve të gjinive të ndryshme dhe përkatësisë etnike• Rregullshmëria, disiplina e arsimtarëve dhe e nxënësve është e kënaqshme në nivel të duhur• Shkolla identifikon nxënësit që kanë vështirësi në mësim dhe nxënësit me talent të veçantë• Përmirëson arritjet e nxënësve përmes mësimin të rregullt dhe plotësues• Arsimtarët kanë njohuri për punën me kompjuter dhe atë e zbatojnë në mësimin e rregullt për realizimin e plan-programeve
Anët negative	<ul style="list-style-type: none">• Shkolla ka nevojë për ndihmë profesionale (si psh, defektolog) për realizimin e procesit edukativo-arsimorë• Mungesa e sallës sportive dhe mjeteve sportive• Mungesa e kabineteve mësimore dhe mjeteve didaktike për realizimin e mësimin bashkëkohor• Mungesa e mjeteve mësimore dhe përmirësimi i inventarit

	shkollor
--	----------

Përfundimi	
Analiza e rezultateve	<p>Sipas analizave nga dokumentat e kontrolluara shihet qartë se arritjet e nxënësve janë në nivel të duhur. Në dokumentat pedagogjike mund të shohim se shkolla ka të dhëna për arritjen e nxënësve dhe rregullshmërinë e tyre në mësim si dhe i analizon shkaqet për mungesën e nxënësve në mësim. Nga pedagogu i shkollës dhe arsimtarët që janë udhëheqës të paraleleve rregullisht bëhen analiza për arritjen e nxënësve sipas lëndëve mësimore.</p> <p>Duke u mbështetur në ditarët e paraleleve në shkollë, shohim se mësimdhënësit realizojnë mësim plotësues nga të gjitha lëndët mësimore për të cilat nxënësit kanë vështirësi dhe për nxënësit që tregojnë arritje më të mëdha.</p> <p>Nga anketat e realizuara gojore, mund të konstatojmë se ekziston bashkëpunimi i arsimtarëve me prindërit dhe prindërit informohen për suksesin e nxënësve. Gjithashtu nga anketat kuptojmë se nxënësit janë të kënaqur me realizimin e procesit edukativo-arsimorë në shkollë dhe nga siguria në shkollë si dhe më tepër e pëlqejnë formën mësimore në grupe.</p>

Punoi:

Anketa për nxënës		<p>Gjithsej të anketuar ishin 28 nxënës.</p> <p style="text-align: center;">Pyetjet për nxënësit</p> <p>1. A ndjehesh i sigurtë në shkollë ?</p> <p>75% ose 21 nxënës janë deklaruar pozitivisht 25% ose 7 nxënës janë deklaruar negativisht</p> <p>2. Cila formë mësimore ju pëlqen më shumë ?</p> <p>7.14% ose 2 nxënës kanë deklaruar se forma frontale ju pëlqen më shumë 78.6% ose 22 nxënës kanë deklaruar se forma grupore ju pëlqen më shumë 14.3% ose 4 nxënës kanë deklaruar se forma në çifte ju pëlqen më shumë</p> <p>3. A fitoni dhurata nga shkolla për suksesin e arritur ?</p> <p>14.3% ose 4 nxënës janë deklaruar pozitivisht 85.7% ose 24 nxënës janë deklaruar negativisht</p> <p>4. A ju duken interesante orët mësimore ?</p> <p>75% ose 21 nxënës janë deklaruar pozitivisht 25% ose 7 nxënës janë deklaruar negativisht</p>
		<p>Gjithsej të anketuar ishin 28 prindër.</p>

Anketa për prindër		<p style="text-align: center;">Pyetjet për prindërit</p> <p>1. A janë korrekt arsimtarët ndaj fëmijëve tuaj ?</p> <p style="padding-left: 40px;">75% ose 21 prindër janë deklaruar pozitivisht 25% ose 7 prindër janë deklaruar negativisht</p> <p>2. A jeni të kënaqur nga Këshillet prindërore ?</p> <p style="padding-left: 40px;">89.3% ose 25 prindër janë deklaruar pozitivisht 10.7% ose 3 prindër janë deklaruar negativisht</p> <p>3. A takoheni shpesh me kujdestarin e klasës?</p> <p style="padding-left: 40px;">82.1% ose 23 prindër janë deklaruar pozitivisht 17.8% ose 5 prindër janë deklaruar negativisht</p> <p>4. A informoheni për suksesin e fëmijëve tuaj ?</p> <p style="padding-left: 40px;">75% ose 21 prindër janë deklaruar pozitivisht 25% ose 7 prindër janë deklaruar negativisht</p>
--------------------	--	---

**FUSHA
MËSIMI**

Fusha nr.3: Mësimi dhe mësimdhënia	
<p>Nr. Treguesi i cilësisë</p> <p>3.1 Planifikimi i mësimdhënies</p>	<p>Temat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkrahja dhe ndjekja e planifikimit të mësimdhënësve • Planifikimet individuale të mësimdhënësve • Shkëmbimi i përvojave dhe informatave gjatë planifikimit • Orari i mësimi
<p>3.2 Procesi mësimor</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Format dhe metodat mësimore • Përdorimi i TIK-ut gjatë mësimi • Zgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe resurseve • Marrëdhëniet interaktive midis mësimdhënësve dhe nxënësve • Qasja e mësimdhënësve dhe nxënësve • Ndjekja e procesit mësimorë
<p>3.3 Përvojat e nxënësve nga mësimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mjedisi i mësimi • Atmosfera e mësimi • Nxitja e nxënësve për marjen e përgjegjësisë • Marrëdhëniet interaktive të nxënësve midis veti dhe me të riturit në shkollë
<p>3.4 Kënaqja e nevojave të nxënësve</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i nevojave arsimore të nxënësve • Respektimi i nevojave të ndryshme të nxënësve në mësim
<p>3.5 Notimi si pjesë e mësimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Politika e shkollës për notim • Metodrat dhe format e notimit • Shfrytëzimi i informatave nga notimi në mësim
<p>3.6 Informimi për përparimin e nxënësve</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Informimi i prindërve për përparimin e nxënësve

**NR.3:
DHE**

MËSIMDHËNIA

3.1 Planifikimet e mësimdhënësve	
Temat: <ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja dhe ndjekja e planifikimit të mësimdhënësve • Planifikimet individuale të mësimdhënësve • Këmbimi i përvojave dhe informacioneve gjatë planifikimit • Orari i mësimi 	<p>Planifikimi i mësimi dhe mësimdhënies në shkollë realizohet në gjuhën shqipe sipas udhëzimeve të Biros për zhvillim të arsimit dhe M.A.Sh.Në shkollë ka qasje të përcaktuara për planifikimin dhe procedura të veçanta për mbështetjen dhe ndjekjen e planifikimit të mësimi nga ana e drejtorit, shërbimit profesional ose persona të caktuar nga organet profesionale. Të gjithë arsimtarët kanë planet globale, tematike – mujore (javore) dhe përgaditje ditore, ku me vete përmbajnë drejtime të qarta se çka duhet të pritët prej nxënësit (rezultatet mësimore) si dhe kur duhet të arrihen ato(rezultatet).</p>
	<p>Qëllimi i mësimdhënies, rezultatet e pritura dhe mënyra e notimit apo vlerësimit të nxënësve janë të përcaktuara me planifikim. Poashtu edhe aktivitetet e nxënësve janë të planifikuara ashtu që koha e të mësuarit dhe mësimdhënies të shfrytëzohet në mënyrë më efektive.</p>
	<p>Poashtu edhe puna e aktiveve profesionale në shkollë bëhet në mënyrë të planifuar, duke kontaktuar mes njëri tjetrit, këmbajnë ide dhe mendime për planifikimin me anë të</p>

	teknologjive të informimit dhe të komunikimit për punën në shkollë etj.
	Orarin e mësimit e bënë shërbimi profesional në bashkëpunim me arsimtarët por duke e respektuar në rend të parë interesin e nxënësve (fëmijëve).
Burimet e të dhënave	
Planifikimet vjetore, tematike dhe ditore, listat për evidencë (instrumentet për ndjekjen e planifikimit të mësimdhënies, bisedë me drejtorin ,mësimdhënësit dhe shërbimin profesional, procesverbalet nga mbledhjet e grupeve profesionale.	

3.2 Procesi mësimorë.	
Temat:	
<ul style="list-style-type: none"> • Format dhe metodat mësimore • Përdorimi i TIK-ut gjatë mësimit • Zgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe resurseve • Marëdhëniet interaktive midis mësimdhënësve dhe nxënësve • Sjellja e mësimdhënësve ndaj nxënësve • Ndjekja e procesit mësimor 	Të gjithë arsimtarët (mësimdhënësit) përdorin metoda dhe forma të llojllojshme mësimore të cilat janë të nevojshme për nxënësit. Mësimdhënësit përdorin metoda dhe forma mirë të planifikuara gjatë orës mësimore për punën e tyre me nxënësit në formë individuale, në grupe etj; të cilat i plotësojnë nevojat e nxënësve gjatë orës mësimore. Në mënyrë të suksesshme i zhvillojnë shkathtësitë individuale të nxënësve.
	Shumica e arsimtarëve janë të stërvitur për përdorimin e TIK-ut dhe të teknologjive të reja arsimore për realizimin e programeve mësimore por nuk përdoren në nivel të duhur.

	Kjo rrjedh nga ajo se edhe shkolla nuk është e pajisur me kompjuter në çdo klasë, por kan vetëm disa klasa të cilat edhe ato nuk funksionojn sa duhet.
	Detyrat që punohen në shkollë ose në shtëpi poashtu janë të planifikuara si duhet dhe arrihen rezultatet e duhura. Mësimdhënësit shfrytëzojnë resurse dhe qasje të ndryshme për realizimin e mësimt e jo vetëm nga teksti (libri) i paraparë për mësim në atë klasë, por edhe nga literatura të ndryshme dhe të dhëna më të reja të marura nga mjetet e ndryshme të informimit dhe të internetit.
	Mësimdhënësit së bashku me nxënësit i ndajnë qëllimet e mësimimit dhe rezultatet e pritura nga mësimi. Shfrytëzojnë metoda të ndryshme që ti inkurajojnë nxënësit, nxisin në të mësuarit dhe risin besimin në mes mësimdhënësve dhe nxënësve. Marëdhëniet në mes nxënësve dhe mësimdhënësve janë në nivel të duhur. Të gjithë mësimdhënësit me nxënësit sillen në mënyrë të drejtë dhe korekte, pa dallim të aspektit gjinor, social, etnik, ose përkatësie fetar.
	Procesi edukativo-arsimorë në shkollë ndiqet nga ana e grupit profesional në shkollë, drejtori i shkollës, nga shërbimi i shkollës, aktiveve profesionale dhe në praktik është këmbimi i përvojave nga ana e arsimtarëve gjatë ndjekjes së punës së kolegëve nga ana e grupit profesional.
Burimet e të dhënave	

Organet e shkollës për ndjekjen dhe vlerësimin e planifikimit të orës mësimore, ndjekjen dhe vlerësimin e realizimit të orës mësimore, ndjekjen dhe vlerësimin e zhvillimit të orës mësimore, ndjekjen dhe vlerësimin e krijimit të atmosferës në klasë, ndjekjen dhe vlerësimin e punës së mësimdhënësve për notimin e nxënësve, ndjekjen dhe vlerësimin e komunikimit të mësimdhënësve dhe nxënësve,

3.3 Përvojat e nxënësve.	
Temat: <ul style="list-style-type: none"> • Ambienti për mësim • Atmosfera për mësim • Nxitja e nxënësve për marrjen e përgjegjësisë • Mënyra interaktive e sjelljes së nxënësve midis veti dhe me të moshuarit në shkollë 	<p>Ambienti për mësim është në nivel edhe pse nuk zhvillohet mësim kabinetik për arsye se na mungojnë klasa dhe kushte por tek nxënësit ekziston motivimi dhe stimuli për punë të mëtutjeshme. Si motivim apo stimul për nxënësit e shkollës paraqet ekspozimi i punimeve të tyre në vendet e dukshme përkatëse (në shkollë dhe në klasë), të cilat ndërohen brenda vitit.</p>
	<p>Nxënësit konsiderojnë se mënyra e mësimin në shkollë është interesante dhe e dobishme për ta sepse ajo do t'ju shërbejë edhe në të ardhmen gjatë jetës. Gjatë orës së mësimin numri më i madh i mësimdhënësve (arsimtarëve) i inkurajojnë nxënësit që atë të cilën e dinë nxënësit ta shprehin në mënyrë të drejtë dhe korekte, të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe kritik, të parashirojnë pyetje dhe të nxjerrin përfundime nga ajo që e mësojnë etj. Gjatë orës mësimore të gjithë nxënësit marin pjesë aktive gjatë orës mësimore.</p>
	<p>Nxënësit mendojnë se kanë mundësi që ta shprehin mendimin e tyre në mënyrë të lirë dhe të drejtë gjatë</p>

	zgjehjes së problemeve në shkollë. Nxënësit marrin edhe përgjegjësi gjatë mësimit dhe jashtë tijë.
	Nxënësit mendojnë se bashkëpunimi mes nxënësve në shkollë është në nivel, nxënësit kanë filluar të punojnë në punime dhe projekte të ndryshme në lëmi të ndryshme në shkollë ku vetë kanë vërejtur se ka një harmoni mes tyre pa marrë parasysh se cila klasë janë ato.
Burimet e të dhënave	
Anketa me nxënësit, bisedë me bashkësinë e nxënësve, me prindërit, me mësime të mësimdhënësve, qasje në dosjet e nxënësve, qasje në evidencën e shërbimit profesional, programi i punës dhe raportet e bashkësisë së nxënësve.	

3.3 Procesi mësimorë.	
Temat: <ul style="list-style-type: none"> Identifikimi i nevojave arsimore të nxënësve Respektimi i nevojave të ndryshme të nxënësve në mësim 	Kuadri arsimorë dhe shërbimi profesional i identifikojnë në mënyrë sistematike nevojat dhe problemet arsimore që paraqiten tek nxënësit dhe ata menjëherë marrin masa për tejkalimin e atij problemi. Në rast nevojë për tejkalimin e kësaj problematike kyçen edhe kujdestari i klasës dhe shërbimet profesionale në shkollë.
	Mësime të mësimdhënësve gjatë procesit edukativ shfrytëzojnë teknika dhe metoda të ndryshme për të qenë sa më të qartë dhe korrekt ndaj nxënësve. Gjatë notimit përdorin metoda dhe teknika të ndryshme për të motivuar nxënësit edhe mëtutje

	për punë të pavarur të tyre.
Burimet e të dhënave	
Anketa me nxënësit, biseda me bashkësinë e nxënësve, me prindërit, me mësimitdhënësit, qasje në dosjet e nxënësve, qasje në evidencën e shërbimit profesional, programi i punës dhe raportet e bashkësisë së nxënësve.	

3.4 Notimi si pjesë e mësimit	
Temat: <ul style="list-style-type: none"> • Politika e shkollës për notim • Format dhe metodat për notim • Shfrytëzimi i informatave nga notimi në mësim 	Shkolla jonë i zbaton dispozitat dhe aktet ligjore për notimin e nxënësve. Shkolla jonë i respekton aktet ligjore por ka edhe kritere të standardizuara (harmonizuara) për notim, të përpiluar nga shërbimi profesional i shkollës me të cilat janë të informuar nxënësit dhe prindërit.
	Mësimitdhënësit përdorin forma metoda dhe mjete të ndryshme për notim si psh: notimit individual, vetënotimit të nxënësve, testimin e përgatitura nga arsimtarët për nxënësitë, notimin me shkrim, mbajtjes së evidencës për çdo nxënës, dhe mbajtjes së dosjeve ku nxënësve u mundësojnë aritjen e rezultateve më të mira.
	Mësimitdhënësit japin informata kthyesë gojore dhe me shkrim mvarësisht se për kë dhe çka bëhet fjalë. Theks të veçant i vihet të ariturave aktuale të nxënësve dhe identifikimin e aktiviteteve të ardhshme që do të zbatohen në mësim, e me këtë përmirësojnë planifikimin dhe zbatimin

	e mësimit.
Burimet e të dhënave	
<p>Programi i shkollës (programi për punën e shkollës), rregullorja për përparim të nxënësve, evidencat pedagogjike, mjetet për notim (testet e diturisë, testet kontrolluese, listat me pika), procesverbalet e grupeve profesionale dhe këshillit arsimorë, intervista individuale me mësime të nxënësve, prindërit dhe nxënësit, evidenca e mësime të nxënësve për takime dhe mbledhje të realizuara prindërore.</p>	

3.5 Raporti për përparimin e nxënësve	
<p>Temat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informimi i prindërve për përparimin e nxënësve 	<p>Shkolla ka sistem të përcaktuar për informimin e prindërve për përparimin e fëmijëve të tyre në mënyrë të rregullt dhe konsekuente. Ky sistem përfshin grumbullimin e rregullt të informatave për arritjen e nxënësve dhe dhënia e informatave konkrete dhe transparente kthyes prindërve (rekomandime më të hollësishme për përmirësimin e suksesit të secilit nxënës veçanërisht. Shfrytëzohen takime formale dhe joformale, grupore (informim për klasën në tërësi me anë të mbledhjeve prindërore) dhe takime individuale (për nxënës të caktuar). Prindëri njoftohen në mënyrë gojore dhe me shkrim me informata për arritjen e nxënësve për çdo lëndë mësimore duke përfshirë edhe zhvillimin personal dhe social të fëmijës. Poashtu nga prindërit kërkohet që të japin informata kthyes pas raportit për arritjen dhe përparimin e fëmijëve të tyre.</p>

Burimet e të dhënave	
Dokumentacionet dhe evidencat pedagogjike, anketa dhe intervista me prindërit dhe evidenca e mësimit nga mbledhjet e realizuara prindërore.	

Anët pozitive dhe negative të fushës nr.:3 Mësimi dhe mësimit	
Anët pozitive	<ul style="list-style-type: none"> -Në shkollë vazhdimisht ndjekën planifikimet e mësimit; -Rregullisht këmbëjnë mendime dhe përvoja për mënyrën e planifikimeve mësimore; -Për çdo vit orari mësimorë përpilohet nga shërbimi profesional ku në rend të parë vihet interesi i nxënësit; -Përdoren forma dhe metoda të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimorë;Atmosfera në mësim është në nivel të duhur; -Sjellja mes mësimit dhe nxënësve është në nivel të mirë; -Mënyra e zhvillimit të procesit edukativo-arsimorë është në nivel e cila mundëson nxitjen e nxënësve për punë të mëtutjeshme dhe të pavarur të tyre; -Me kohë identifikohen nevojat arsimore të

	<p>nxënësve të cilat janë me nevoja të kufizuara;</p> <p>-Notimi i nxënësve kryhet sipas standardeve dhe kritereve të duhura.</p>
Anët negative	<p>-Shkolla ka nevojë për ndihmë profesionale që të tejkalohen problemet me nxënësit që janë me nevoja të veçanta (edhe pse numri i tyre është relativisht i vogël);</p> <p>-Përdorimi i TIK-ut gjatë mësimit dhe mësimdhënies nuk është në nivel të duhur për arsye të mungesës së klasave (mësojtoreve) me paisje të kompjuterëve edhe pse mësimdhënësit janë të trajnuar për përdorimin e TIK-ut.</p>

Përfundimi	
Analiza e rezultateve	<p>-Në shkollë vazhdimisht ndjekën planifikimet e mësimdhënësve, këmbëjnë mendime dhe përvoja për mënyrën e planifikimeve mësimore, me përdorimin e formave dhe metodave të ndryshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit edukativo-arsimorë;</p> <p>-Në shkollë atmosfera për punë është në nivel të</p>

	<p>duhur, raportet dhe sjellja mes mësimeve të nxënësve të mira,</p> <p>-Mënyra e zhvillimit të procesit edukativo-arsimor mundëson nxitjen e nxënësve për punë të mëtutjeshme dhe të pavarur të tyre, ku me kohë identifikohen nevojat arsimore të nxënësve;</p> <p>-Notimi ose vlerësimi i nxënësve kryhet sipas standardeve dhe kriterëve të duhura në shkollë.</p> <p>-Orari mësimorë përpilohet nga shërbimi profesional ku në rend të parë vihet interesi i nxënësve;</p> <p>-</p>
<p>Aktivitetet e ardhshme që do të kryhen në planin zhvillimor të shkollës</p>	<p>-Në shkollën tonë në të ardhmen planifikohet të ketë disa trajnime për arsimtarët-mësimeve të ndihmë profesionale për tejkalimin e problemeve me nxënësve që janë me nevoja të veçanta (edhe pse numri i tyre është i vogël);</p> <p>-Për mësime më të mirë planifikohet që në të ardhmen shkolla jonë të furnizojë me mjete, materiale ku do të realizohet më mirë procesi edukativo-arsimorë në lëndë të ndryshme ,planifikon mësime kabinetik për mësime lëndore dhe mjeteve didaktike për mësime bashkohore.</p> <p>-Si aktivitet për në të ardhmen planifikohet që në shkollën tonë të gjithë arsimtarët klasorë por edhe</p>

	ato lëndorë ti kushtojnë kujdesë zhvillimit profesional,të përdorin metoda interaktive gjatë zhvillimit të procesit edukativo-arsimor. Të përdorin kompjuterë gjatë zhvillimit të njesisë mësimore sepse të gjithë arsimtarët janë të trajnuar për përdorimin e TIK-ut dhe aplikacioneve të ndryshme.
--	---

Antarët e timit:

1. Sejhan Idrizi
2. Lumturije Rakipi
3. Faton Seferi
- 4.Besnik Selimi
5. Zeliye Rushiti
- 6.Shermin Kameri

Fusha 4. Mbështetja e nxënësve

Nr. Treguesi i cilësisë

4.1 Kujdesi i gjithëmbarshtëm për Nxënësit

Temat:

- Mbrojta nga lëndimet fizike dhe fatkeqësit elementare
- Preventiva ndaj dhunës
- Mbrojta nga konsumimi i duhanit, alkooli dhe drogës
- Cilësia e ushqimit që përdoret
- Mbështetja e nxënësit me të meta fizike
- Kujdesi për nxënësit që rrjedhin nga familjet me gjendje të vështirë ekonomike.

4.2 Shëndeti

- Higjiena dhe mbrojtja nga sëmundjet
- Kujdes për nxënësit me problem shëndetsore

4.3 Ndhimja këshillëdhënëse për arsimin e mëtejshëm të nxënësve

- Ofrimi i ndihmës për zgjedhjen e profesionit /institucionit për arsim të mëtejshëm, rikualifikim ose punësim
- Kujdes për nxënësit me vështirësi emocionale

4.4 Ndjekja e zhvillimit

- Mbajtja e evidences për përparimin individual të nxënësve
- Analiza e përparimit të nxënësve sipas paraleleve

4.1 Kujdesi I gjithëmbarshëm për nxënësit

Temat :

- Mbrojta nga lëndimet fizike dhe fatkeqësi elementare
- Preventiva ndaj dhunës
- Mbrojta nga konsumimi i duhanit, alkooli dhe drogës
- Cilësia e ushqimit që përdoret
- Mbështetja e nxënësit me të meta fizike
- Kujdesi për nxënësit që rjedhin nga familje me gjendje të vështirë sociale

1.1. Mbrojta nga lëndimet fizike dhe fatkeqësi elementare

Hapsira shkollore është e sigurt për zhvillimin e mësimin.

Shkolla ka rregullore të caktuara dhe aktivitete për sigurimin e nxënësve gjatë mësimin në ndërtesën shkollore.

Nxënësit dhe të punësuarit janë të siguruar nga Agjensioni i Sigurimit "UNIQA". Po ashtu në shkollën jepen këshilla nga të punësuarit e ministrisë së punëve të mbrenshme.

Sipas të dhënave të anketës nga ana e prindërve janë deklaruar se 90% janë shumë të kënaqur nga kujdesi dhe siguria e nxënësve në shkollë.

Kurse nga ana e arsimtarëve kanë shumë kujdes për shëndetin dhe sigurimin fëmijeve.

1.2. Preventiva ndaj dhunës

Shkolla kujdeset për mbrojtjen e nxënësve që në shkollë të mos përdoret dhuna por në qoftë se hasim rast tek fëmijët menjëherë duhet ndërmarë këshilla pedagogjike dhe

ligjerata pedagogjike ashtu siç janë dhënë nga anketa e arsimtarëve të gjithë anketuesit janë përgjigjur pyetjes se pse marrim këshilla pedagogjike, si dhe mbahen ligjerata në orët e shkathtësive jetësore dhe në orët e kujdestarisë.

1.3. Mbrojtja nga konsumimi I duhanit, akoolit dhe drogës

Shkolla disponon me metoda të cilët kanë të bëjnë për ndalimin e konsumimit të duhanit,alkoolit dhe substancave narkotike.

Në shkollë mbahen orë të kujdestarisë ku i përmbajnë po edhe këto të dhëna, poashtu bashkëpunon edhe organizojm ligjerata të posaçme lidhur me këtë temë siç janë ligjeratat të mbajtura nga ana e Kryqi të kuq , në lidhje me temat;]: alkooli,duhani si dhe substancat narkotike.

Poashtu edhe nga anketa e arsimtarëve është dhënë përgjigje 80% janë të kujdesëshëm ndaj nxënësve kurse 20% nxënësit janë përgjigjur poashtu arsimtarët kujdesen për ta.

1.4 Cilësia e ushqimit që përdoret

Shkolla nuk posedon ushqim për furnizimin e nxënësve ashtu që nxënësit vet kujdesen për ushqim nëpër objekte shërbyese në afërsi të shkollës.

1.5. Mbështetja e nxënësve me të meta fizike në zhvillim

Qasja e shkollës nuk është e përshtatshme për nxënës me të meta fizike në zhvillim. Shkolla nuk ka mekanizma për ti inkuadruar nxënësit që t'ju jap ndihma dhe të kujdesen për fëmijët me të meta fizike në zhvillim.

1.6. Kujdesi për nxënësit që rrjedhin nga familjet me gjendje të vështirë sociale

Shkolla ka dispozita të shkruara për nxënësit me gjendje të vështirë sociale ashtu që disponon me ndihma nga ana e organizatave joqeveritare siç janë: OJQ "Zip Institut" të cilët shpërndanë gjithësej 34 tabletë për nxënës me kushte të vështira ekonomike si dhe kompania "Dauti komerc" poashtu ndau tabletë për nxënësit e këtyre kategorive. Nga organizata humanitare El Hilal që donoi veshmbathje dhe ushqim për nxënësit skamnorë (të vobekët), Vetëqeverisja lokale ndau paketa me rastin e festës së vitit të ri për nxënësit e kl.

Burimet e të dhënave:

Programi i punës së drejtorit, programet e punës së shërbimit profesional . Procesverbalet dhe bisedat individuale me nxënësit dhe prindërit.
Qasje në evidencën pedagogjike, Dosjet e nxënësve. Programi vjetor për punën e shkollës.

4.2 Shëndeti

Temat:

- Higjiena dhe mbrotja nga sëmundjet
- Kujdes për nxënësit me probleme shëndetsore

2.1 Higjiena dhe mbrotja nga sëmundjet

Higjiena e shkollës është në nivel të duhur.

Shërbimi teknik kujdest për mirëmbajtjen e higjienës në shkollë, poashtu që mos të pengojë procesin edukativo-arsimor si dhe ka bashkëpunim me institucione shëndetësore siç janë ambulanca ku nxënësit marrin vakcina të regullta.

Kontrolluar nga ana e mjekëve të dhëmbëve .

2.2 Kujdesi për nxënësit me probleme shëndetsore

Shkolla kujdeset për nxënësit me probleme shëndetsore si dhe merr masa dhe bashkëpunon me prindërit.

Poashtu edhe nga anketa me prindërit dhe arsimtarët janë dhënë të dhëna që kujdesemi shumë për shëndetin e fëmijëve me probleme shëndetsore.

Burimet e të dhënave:

Programi vjetor i punës së shkollës .
Rregullorja,sistematizimi i vendeve të punës . Qasja në hapsirën e shkollës.

4.3 Ndhimja këshillëdhënëse për arsimin e mëtejshëm të nxënësve

Temat:

- Ofrimi i ndihmës për zgjedhjen e profesionit /institucionit për arsim të mëtejshëm, rikualifikim ose punësim/
- Kujdes për nxënësit me vështirësi emocionale

3.1 Ofrimi i ndihmës për zgjedhjen e profesionit /institucionit për arsim të mëtejshëm, rikualifikim ose punësim

Shkolla u siguron nxënësve informata të qarta dhe të reja për mundësitë për shkollim të mëtejshëm.

Për këtë qëllim organizon aktivitete dhe shfrytëzon material promovues të institucioneve arsimore.

Shkolla ka bashkëpunim me prindërit për nxënësit për arsimimin e mëtejshëm. Në shkollën tonë bëhet anketimi i nxënësve për regjistrim në shkollat e mesme nga ana e pedagogut të shkollës. Në orën e kujdestarisë nxënësit këshillohen sa i përket vazhdimit të shkollimit të mëtutjeshëm.

Poashtu ka bashkëpunim me shkolla të mesme si dhe bën vizitë të nxënësve nëpër shkolla dhe bëhet vlerësimi i të arriturave të tyre.

Poashtu nga anketa me prindërit dhe nxënësit janë dhënë të dhëna se 100% këshillohen dhe ju ofrojnë ndihmë për arsimim të mëtejshëm.

3.2 Kujdes për nxënësit me vështirësi emocionale

Shkolla posedon dispozita të shkruara për kujdesin e nxënësve. Nxënësve me vështirësi u ofrojmë ndihma si dhe bashkëpunojmë me prindërit për vështirësitë e tyre.

Burimet e të dhënave:

Proçes verbalet nga mbledhjet prindërore. Anketa me nxënësit , dhe prindërit.
Proçes verbal nga bisedat individuale me prindërit dhe nxënësit. Evidenca pedagogjike për nxënësit me problem shëndetsore.

4.4 Ndjekja e zhvillimit

Temat:

- Mbajtja e evidences për përparimin individual të nxënësve
- Analiza e përparimit të nxënësve sipas paraleleve

4.1 Mbajtja e evidences për përparimin individual të nxënësve

Mësimdhënësit mbajnë evidence të rregullt dhe të plotë të arritjeve të nxënësve, Mësimdhënësit e ciklit të ulët veçanërisht mbajnë evidencë për të arriturat e nxënësve dhe dosje të vaçant për secilin nxënës dhe çek lista të nxënësve ku notohen rregullisht me shkrim. Në evidencë përfshihen të gjitha të dhenat e nxënësve që janë bërë si vlersim nga ana e mësimdhënësve.

4.2 Analiza e përparimit të nxënësve sipas paraleleve

Mësimdhënësit paraqesin raporte për analizat të rregullta tremujore dhe në fund të gjysëmëvjetorit duke u mbështetur në evidencat e nxënësve. Këto analiza të përgaditura dorëzohen në mbikëqyrje të shërbimit profesional gjëgjësisht nga ana e pedagogut të shkollës ku këto analiza shfrytëzohen si indikator për përmisimin e procesit edukativo- arsimor. Të gjithë nxënësit janë të evidentuar në librin kryesor nxënësit që shpërngulen nga shkolla kanë dukumentacion të shfletëshpërnguljeve

Burimet e të dhënave:

Raportet dhe analizat. Shqyrtimi i evidencës dhe dukumentacionit pedagogjik. Evidenca e nxënësve që kanë shkuar dhe nxënësve të ardhur. Bisedat me mësimdhënësit dhe shërbimin profesional Listat evidentuese.

Temat:

- Mbështetja e nxënësve me nevoja të veçanta

Anët Negative

Evidenca dhe informimi i shkollës për nxënës me nevoja të veçanta. Nuk ka kushte të mjaftueshme për nxënësit me nevoja të veçanta. Shkolla jonë ka nevojë për defektolog apo asistent arsimorë.

Analiza e rezultateve

Në shkollën tone nxënësit kanë mbështetje nga mësimeve dhe nga ana e prindërve. Sa i përket lëndimeve fizike gjatë procesit edukativo arsimorë, nxënësit e shkollës sonë janë të siguar në agjencionin e sigurimeve EUROLINK.

Që mos të përdoren substancat narkotike mësimeve ligjorë dhe i këshillojnë gjatë orëve të kujdestarisë dhe shkathtësive jetësore. Sa i përket

Dhunës në shkollën tone merren masa pedagogjike dhe masa preventive kundër dhunës në shkollë .

Shkolla jonë u jep përkrahje nxënësve që kanë kushte të dobta material gjithashtu

- Aktivitetet e ardhshme

këtyre nxënësve u sigurojmë donacione të ndryshme nga organizatat joqeveritare dhe donator të ndryshëm. Sa i përket arsimimit të mëtutjeshëm të nxënësve që mbarojnë shkollën tone ne u japim këshilla për vazhdimin e shkollimit të mëtutjeshëm.

Evidenca dhe informimi i shkollës për nxënës me të meta fizike në zhvillim. Nuk ka kushte të nevojshme për nxënësit me të meta fizike.

Shkolla jonë ka nevojë për defektolog.

Antarër e timit:

1. Ilirjana Selimi
2. Gjilfije Ziberi
3. Zade Ademi
4. Sejhan Idrizi

Fusha nr.5: Atmosfera shkollore dhe Marrëdhëniet në shkollë

nr. Treguesi I cilësisë

Temat

5.1 Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë

- Prestigji/ imazhi i shkollës
- Kodi i sjelljes
- Atmosfera e shkollës
- Sjellja dhe disiplina në shkollë
- Participimi i nxënësve në zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve

5.2 Promovim i arritjeve

- Promovimi i arritjeve personale të nxënësve
- Promovimi i arritjeve në emër të shkollës

5.3 Barazia dhe drejtësia

- Njohja e të drejtave të fëmijëve
- Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve
- Pranimi dhe promovimi i multikulturalizmit

5.4 Marrëdhënie partnere me prindërit, me komunën dhe me komunitetin afarist

- Bashkëpunimi i shkollës me prindërit
- Bashkëpunimi me bashkësinë lokale
- Bashkëpunimi me komunitetin afarist dhe sektorin joqeveritar

5.1 Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë

Temat:

- Prestigji/imazhi i shkollës
- Kodi i sjelljes
- Atmosfera e shkollës
- Sjellja dhe disciplina në shkollë
- Participimi i nxënësve në zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve

-Prestigji/imazhi i shkollës

Procesi edukativo-arsimor në shkollën tonë zhvillohet në 3- objekte shkollore ,në atë qendrore Bojan dhe në dy shkollat periferike, në f.Llaskarc dhe f.Panicar. Shkolla jonë njihet për cilësi të pranuar të punës dhe sipas arritjeve të nxënësve në lëmi të ndryshme, si dhe sipas realizimit të vizionit dhe misionit të shkollës. Shkolla kujdeset për shëndetin dhe sigurinë e nxënësve edhe atë duke bërë kontrollimin dhe vaksinimin e tyre për çdo vit.Këtë më së miri e shohim në evidencën e kartoneve mjeksore si dhe në ditarët e klasave në rubrikën shëndeti i nxënësve. Në shkollën tonë organizojmë ligjerata nga kryqi I kuq përmes projektit HPV, kushtuar sëmundjeve ngjitëse si dhe mbrojtja e nxënësve nga duhani dhe alkooli. Sa i përket sigurimit të nxënësve në bashkëpunim me prindërit i siguroam nxënësit e shkollës tonë në shoqatën e sigurimeve **UNIQA**.

Kodi i sjelljes-Shkolla jonë posedon kod të sjelljes me anë të së cilës janë përcaktuar parimet dhe dispozitat e sjelljes së të gjitha strukturave në shkollë.Gjatë miratimit të këti kodi kanë marrë pjesë përfaqësues të të gjitha strukturave(Kuadri udhëheqës,shërbimi profesional,personeli teknik.nxënësit dhe prindërit).

Atmosfera e shkollës-Gjatë vitit shkollor 2020/21-2021/22 marrëdhëniet midis nxënësve dhe kuadrit arsimor bazohen në respektimin reciprok mes tyre. Lirisht mund të themi se marrëdhëniet ndëretnike ,konfesionale janë në nivel , sepse mbizotëron toleranca,respekti dhe bashkëpunimi.Karakteristike është se në shkollën tone nuk ka dallime të nxënësve në bazë të etnive , aftësive psiko-fizike si dhe gjinore.

Disiplina- në shkollën tone disiplina është në nivel këtë vit, sepse ka atmosferë pune gjatë mësimit dhe aktiviteteve jashtëmësimore.Ka bashkëpunim mes kuadrit arsimor dhe nxënësve.Shkolla e respekton rregulloren e masave pedagogjike dhe lirisht mund të themi se gjatë viteve shkollore 2020/21-2021/22 nuk kemi të propozuar asnjë masë pedagogjike nga ana e kujdestarëve të klasave sa i përket masave më të rënda.

Shkolla ka bashkësi të nxënësve të zgjedhur nga ana e klasave.Kjo bashkësi është zgjedhur në mënyrë demokratike dhe janë të informuar me kohë për çdo problem dhe marrin pjesë direkte në zgjidhjen e tyre.

Burimet e të dhënave

Kodi i sjelljes, Anketat dhe intervistat gojore me mësimdhënësit,prindërit dhe nxënësit,evidencë pedagogjike për masat e shqiptuara padagogjike, statuti i shkollës,rregulli shtëpiak i shkollës,lëvdata çmimet ,mirënjohjet.etj.;

5.2 Promovimi i arritjeve

Temat:

- Promovimi i arritjeve personale të nxënësve
- Promovimi i arritjeve në emër të shkollës.

Promovimi i arritjeve personale të nxënësve-Shkolla jonë vë theks të veçantë në arritjet e nxënësve.

Këtë më së miri e shohim në pjesëmarrjen aktive të nxënësve tanë në garat komunale që i organizon Komuna e Sarajit për çdo vit tradicionalisht “Olimpiadën e diturisë”.

Nga kjo garë nxënësit tanë kanë korrur edhe rezultate të mira duke u bazuar në mirnjohjet dhe shpërblimeve të tjera. Si dhe gara interne mes shkollave.

Sa i përket arritjes personale të nxënësve këtë e bëjmë ne si shkollë 4 herë në vit edhe atë në tremujorshin e parë ,gjysëmvetorin e parë,tremujorshin e dytë dhe në fund të vitit.Nxënësve u japim fletat evidentuese ku ata ,nënshkruhen nga ana e prindërve gjë që tregon edhe bashkëpunimin tonë me prindër.

Shkolla jonë ka një politikë të nxitjes së kuadrit arsimor dhe të nxënësve që të marrin pjesë dhe të arrijnë sukses në garat komunale dhe garave Republikane dhe jashtë vendit.

Shkolla jonë çdo herë e ka parasysh promovimin e arritjeve të shkollës sonë,organizohen teste diturish, në nivel të shkollës, çdo rezultat të arritur e raporton në këshill të shkollës ,në këshillin e prindërve si dhe në Komunë.

Shkolla bën përpjekje të mëdha që të mundësojë një bashkëpunim më të madh mes prindërve dhe Komunës Saraj.

Burimet e të dhënave

Raportet dhe analizat statistikore, Evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik evidencë e nxënësve që kanë shkuar dhe atyre që kanë ardhur, bisedat me mësimdhënësit dhe shërbimin profesional;

5.3 Barazia dhe të drejtat

Temat:

- Njohja e të drejtave të fëmijëve
- Trajtimi i drejtë dhe i barabartë i të gjithë nxënësve
- Pranimi dhe promovimi i multikulturës

Njohja e të drejtave të fëmijëve-Të gjithë të punësuarit në shkollën tone i dinë dhe i respektojnë të drejtat e fëmijëve, poashtu edhe nxënësit respektohen në mes vete pa dallim etniteti feje apo gjinije ,këtë më së miri e shohim edhe nga anketa e bërë me nxënës mësimdhënës dhe prindër.

Trajtimi i drejtë dhe i barabartë i të gjithë nxënësve-

Duhet theksuar se në shkollën tone nuk kemi patur raste të mos tolerancës dhe respektit të ndërsjellë pamarë parasysh gjininë etninë fenë etj

Në shkollën qendrore „Ibe Palikuqa,,- Bojanë kemi 18-paralele në gjuhën shqipe që numërojnë 506 nxënës, prej tyre 228-femra dhe 278-meshkuj ku gjer tani nuk kemi asnjë zënkë në mes nxënësve bile të theksojmë se kemi bashkëpunim të nxënësve, kjo tregon se shkolla jonë promovon një sjellje shembullore në mes etnive të ndryshme.

Nxënësit tanë në shkollën tone mësojnë dhe respektojnë kulturën e tyre dhe të tjerëve këtë mund ta shohim edhe nga anketa e bërë mes nxënësve prindërve dhe mësimdhënësve

Burimet e të dhënave

Evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik,Raport për përfshirjen e nxënësve në aktivitetet jashtëmësimore,Struktura e paraleleve, anketa me nxënësit,prindërit,intervista gojore me shërbimin profesional,Ditari për punën e shërbimit profesional.

5.4 Marrëdhënie partnere me prindërit dhe me bashkësinë lokale dhe afariste

Temat:

- Bashkëpunimi i shkollës me prindërit
- Bashkëpunimi me bashkësinë lokale
- Bashkëpunimi me bashkësinë afariste dhe sektorin joqeveritar.

Shkolla jonë ka një bashkëpunim të mire me prindërit, e cila cakton mbledhje të rregullta brenda vitit shkollorë si dhe takime të ndryshme në interes të nxënësve. Sa i përket suksesit dhe rregullshmërisë së nxënësve prindërit njoftohen me kohë nga mësimdhënësit me anë të fletave evidentuese,dhe nga raporti i përgatitur nga shërbimi profesional ku në detaje raporton pranë këshillit arsimor,këshillit të prindërve dhe këshillit të shkollës. Deri tani në shkollën tonë nuk kemi të adresuar as një ankesë nga ana e prindërve.Shpesh ndodh që shkolla jonë të organizojë aktivitete jashtëmësimore ,ku edhe vet prindërit participojnë me kontributin e tyre . Shkolla realizon bashkëpunim me bashkësinë lokale. Shpesh ndodh që për nevojat

e ndryshme të shkollës të kontribojë edhe bashkësia lokale.
 Në një organizim të tillë u mbledhën fonde dhe me ato fonde shkolla u pajisë me disa printer,projektor si dhe lektyra shkollore.
 Në shkollën periferike në f.Llaskarcë u instaluan nxemjet qëndrore.
 Me një objektiv të veçantë, përkujdesjen e fëmijve tanë si dhe çdo gjenerate të re ti krijojmë kushte më të përshtatshme për suksese më cilësore nga gjeneratat paraprake. „Do të përpiqemi të ndërtojmë shkolla të reja nepërmjet partneritetit publik-privat me qëllim të krijimit të kushteve optimale për nxënësit si dhe për eliminimin e mësimin në turne si penges e kahmotçme.
 Shoqata “Logos A” donoi 120 libra për bibliotekën e shkollës.
 Komuna e Saraj-it,sektori për arsim për kl.I dhuroi çanta dhe materiale shkollore.

Burimet e të dhënave

Raporti për punën e shkollës(gjysëmvetor,vjetor),Procesverbalet e këshillit të prindërve dhe mbledhjeve prindërore,Anketë gojore me drejtorin dhe shërbimin profesional,anketë me mësimdhënësit ,prindërit dhe nxënësit,Dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike,Statuti i shkollës,Marrveshjet me bashkësitë afariste,Projektet e shkollës sa i përket aktiviteteve jashtëmësimore të nxënësve,Dokumentacion për donacionet..

Rezultatet

Përparsitë

- Bashkëpunimi i shkollës me prindërit,bashkësinë lokale dhe me organizata jo qeveritare dhe afarist të fshatit.

Dobësitë

- Puna me ekipe ,aktivet profesionale nuk funksionoj sa duhet..
- Mësim klasik e jo kabinetik.
Krijimi I hapsirave dhe kushteve për të punuar me një ndrrim shkollat
- Mungesa e kushteve për mësim bashëkohor të inovuar

- Bashkëpunimi me organizatën jo qeveritare
- Bashkëpunimi me shoqatën humanitare “ El Hilal”
- Marrdhëniet e mira ndër etnike dhe fetare.

Analiza e rezultateve

Në shkollën tone mësimi zhvillohet në gjuhë.shqipe .

Kemi 2 shkolla periferike në f.Llaskarc dhe në f.Panicar.

Në shkollën tone punohet në dy ndryme poashtu edhe shkollat periferike punojmë me dy ndryme.

Marrdhëniet ndër etnike dhe fetare në mes nxënësve dhe të punësuarve janë në nivel.

Aktivitetet në të ardhmen

- Ti rruajmë raportet e mira ndër etnike dhe fetare në shkollën tone.
- Bashkëpunimi i shkollës sonë me prindërit të jet më në nivel.
- Të vazhdojë bashkëpunimi me shoqatat qeveritare dhe jo qeveritare.
- Bashkëpunimi me organizatat e sigurimit.
- Bashkëpunimi me shoqatat humanitare.
- Bashkëpunimi me ministrinë e arsimit dhe me Komunen.
- Zgjerimi i hapsirës mësimore
- Përmirsimi i kushteve mësimore

Antarët e ekipit:

1. Ilirjana Selimi
2. Faton Seferi
3. Zamir Avdiu
4. Besnik Selimi

Fusha Nr.6: Resurset

Nr.	Indikator i kualitetit	Temat
6.1	Vendosja dhe kapaciteti hapsinor	<ul style="list-style-type: none">• Kushtet hapsinore• Perdorimi i kapaciteteve hapsinore
6.2	Mjete dhe materiale mësimore	<ul style="list-style-type: none">• Pajisja me literaturë profesionale dhe mjete mësimore dhe ndihmëse• Biblioteka shkollore• Furnizimet
6.3	Sigurimi i kuadrit të nevojshëm arsimor	<ul style="list-style-type: none">• Numri i të punësuarve dhe kuadri arsimor përkatës• Efektiviteti dhe shpërndarja e kuadrit• Shërbimi profesional si përkrahje e kuadrit arsimor
6.4	Përcjellja e nevojave zhvillimore të kuadrit arsimor	<ul style="list-style-type: none">• Zhvillimi profesional i mësimdhënësve
6.5	Puna finansiare në shkollë	<ul style="list-style-type: none">• Procedurat me të cilat respektohet regullativa ligjore për punën finansiare• Transparencë në planifikimin dhe harxhimin e buxhetit të shkollës .

6.1 Vendorsja dhe kapaciteti hapsinor

Temat:

- Kushtet hapsinore
- Përdorimi i kapaciteteve hapsinore

Procesi edukativo arsimor në shkollën tonë zhvillohet në **një shkollë qendrore dhe dy shkolla periferike**.

Shkolla qendrore ndodhet në f.Bojanë dhe disponon me :

- Zyrë të mësimdhënësve (1)
- Hapsirë administrative (3)
- Klasa (9)
- Bibliotekë (0)
- Koridor (2)
- Toalet (3)
- Podrum (1)

-Në fillim të vitit shkollor 2021/2022 shkolla qendrore plotësoi nevojën e shkollës për ndërtimin e toaletve brenda hapsirave shkollore për qasje më të lehtë të nxënësve dhe mësimdhënësve dhe personelit shkollor.

Shkolla periferike në f.Llaskarcë disponon me :

- Zyrë të arsimtarëve (1)
- Klasa (5)
- Toalet (3)
- Korridor (1)
- Podrum (1)

Shkolla periferike në f.Paniçarë disponon me :

- Zyrë të arsimtarëve (1)
- Zyre administrative
- Klasa (3)
- Toalet (2)
- Korridor (1)
- Podrum (1)
- Në vitin 2021 filluan punimet për ndërtimin e një godine të re dhe punimet për ndërtimin e shkollës së re vijojnë ende.

Burimi I të dhënave

Plani vjetor për punë;plani për zhvillim të shkollës;mbikqyrje të afërt ;raportet nga inspektoriati arsimor dhe sanitar ;orari I orëve;raporti gjysëmvetor dhe vjetor ;intervju me mësime dhënësit etj.

6.2 Mjete dhe materiale mësimore

Tema:

- Pajisja me literaturë profesionale dhe mjete

Literatura profesionale mungon dhe jemi në procedurë e sipër për kompletimin e

mësimore dhe ndihmëse

- Biblioteka e shkollës
- Furnizimet

tyre. Gjatë vitit shkollor 2021/2022 nga ana e BZHA shkolla është pajisur me mjete për kabinetin e shkencave natyrore dhe të njejtat janë vendosur në përdorim. Me vet iniciativ të donatorëve dhe prindërve shkolla është pajisur me projektor në çdo klasë dhe një printer në zyrën e arsimtarëve me qëllim mbarvajtjen e procesit edukativo-arsimor sipas kushteve moderne. Kompjuterët nuk janë funksionalë në çdo klasë çka e pamundëson vijim e orës në mënyrë të duhur.

Nuk kemi hapsirë të veçantë për bibliotekën e shkollës. Shkolla posedon me lektyra dhe libra për nxënësit nga klasa e I deri IX edhe pse numri i tyre është shumë i vogël.

Shkolla planifikon dhe me kohë siguron realizimin e aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore në pajtueshmëri me planin e shkollës.

Burimi I të dhënave

Dokumentacioni I shkollës për furnizimi me literaturë profesionale dhe mjete ndihmëse ;bisedë me mësimdhënësit ,shërbimin profesional dhe drejtorin;dokumentacioni evidentues I bibliotekës,raporti gjysëmvetor dhe vjetor , programi vjetor .

6.3 Sigurimi I kuadrit të nevojshëm Arsimor

Tema:

- Numri I të punsuarve dhe kuadri arsimor përkatës
- Efektiviteti dhe shpërndarja e kuadrit
- Shërbimi profesional si përkrahje e kuadrit arsimor

Kuadri arsimorë të shkollës e përbëjnë 48 mësimdhënës të mjaftueshëm për realizimin e procesit edukativo arsimorë. Kuadri arsimorë posedon kualifikim, shkathtësi dhe përvojë të marur nga trajnime të ndryshme megjithatë për nevojat e nxënësve dhe shkollës në përgjithsi ka mungesë të kuadrit përkatës. Përvoja e punës, kualifikimet dhe profesionaliteti i kuadrit të shkollës është e theksuar në tabelë:

Mësim klasor-(Në kohë të pacaktuar)

Nr.	Emri dhe mbiemri	Shkalla e arsimimit	Vendi i punës	Shkolla	Klasa	Nr i orëve
1.	Imrane Kryezi	Sipërorë	Mësimdhënës klasor	Bojanë	I	20
2.	Ibadete Hoxha	Ar.i lartë	Mësimdhënës klasor	Bojanë	I	20
3.	Suzana Dauti	Sipërorë	Mësimdhënës klasor	Bojanë	IV	20
4.	Rauf Pajaziti	Sipërorë	Mësimdhënës klasor	Bojanë	IV	20
5.	Rizvan Veseli	Ars.i lartë	Mësimdhënës klasor	Bojanë	V	20

6.	Bujamin Hasani	Sipërorë	Mësimdhënës klasor	Bojanë	V	20
7.	Nerxhivane Jasahri	Ars.i lartë	Mësimdhënës klasor	Bojanë	II	20
8.	Rakibe Beluli	Sipërorë	Mësimdhënës klasor	Bojanë	II	20
9.	Safit Rushiti	Ar.i lartë	Mësimdhënës klasor	Bojanë	III	20
10.	Sejad Osmani	Sipërorë	Mësimdhënës klasor	Bojanë	III	20
11.	Miqereme Ziberi	Sipërorë	Mësimdhënës Klasor	Llaskarcë	I	20
12.	Sevime Halimi	Sipërorë	Mësimdhënës klasor	Llaskarcë	I	20
13.	Nurtene Ibishi	Sipërorë	Mësimdhënës klasor	Llaskarcë	IV	20
14.	Gjyltene Fejzullah	Ars.i lartë	Mësimdhënës klasor	Llaskarcë	III	20
15.	Xhemisat Izeti	Ars.i lartë	Mësimdhënës klasor	Llaskarcë	II	20
16.	Ruhide Shabani	Ars.i lartë	Mësimdhënës klasor	Llaskarcë	V	20
17.	Bekim Mamuti	Sipërorë	Mësimdhënës klasor	Paniçarë	I	20
18.	Sedat Qazimi	Sipërorë	Mësimdhënës klasor	Paniçarë	II	20

Mësim lëndor(më kohë të pacaktuar)

Nr	Emri dhe mbiemri	Shkalla e shkollimit	Vendi I punës	Nr I orëve
1.	Zade Ademi	Sipërorë	Gjuhë shqipe	
2.	Nurtene Rexhepi	Sipërorë	Gjuhë shqipe	
3.	Sabahudin Ramadani	Ars.i lartë	Gjuhë frenge	
4.	Rexhep Mejd	Ars.i lartë	Gjuhë maqedone	
5.	Xhevat Doko	Ars.i lartë	Matematikë	
6.	Fevzi Musli	Ars.i lartë	Matematikë/Fizikë	
7.	Besim Beça	Ars.i lartë	Histori	
8.	Zamir Avdi	Sipërorë	Gjeografi	
9.	Besnik Selimi	Sipërorë	Gjuhë angleze	
10.	Zulejha Shaqiri	Sipërorë	Gjuhë Angleze	
11.	Refedije Qazimi	Sipërorë	Gjuhë shqipe	
12.	Perihane ismaili	Ars.i lartë	Gjuhë maqedone	
13.	Sejhan Idrizi	Sipëror	Biologji	
14.	Faton Seferi	Sipëror	Matematikë	
15.	Zejnije Jakupi	Sipëror	Kimi/Shk.natyrore	
16.				

Mësimdhënësit në mënyrë efektive kontribuojnë për funksionimin e shkollës dhe me sukses punojnë si skuadër në kuadër të aktiveve profesionale.Gjatë shpërndarjes së kuadrit merren parasysh kualiteti,përvoja dhe ekspertiza e mësimdhënësve çka kontribuon në përmbusjen e qëllimeve të mësimnxënës.Kur është e përshtatshme,shkolla angazhon mësimdhënës të specializuar për ndonjë lëmi të cilët punojnë efektivisht me kuadrin arsimor të shkollës.Në rast të

mungesës së shkurt apo më të gjatë të ndonjërit nga kuadri arsimor shkolla ka mehanizëm për ndrim të shpejt dhe adekuat. Angazhon pedagogen e shkollës për ti zëvendësuar arsimtaret që mungojnë një kohë të gjatë.

Në shkollë ka shërbim profesional të cilët ju ndihmojnë mësime dhënëse në organizimin e mësimit, përcjelljen e përparimit të nxënësve, ballafaqimin me problemet në nivel individual dhe kolektiv dhe dhënie të ndihmës përkatëse të nxënësve. Shërbimi profesional është çdoher i hapur për bashkpunim.

Burimi I të dhënave

Dosjet e të punësuarve; rregullorja për sistematizim; biseda me drejtorin dhe mësime dhënësit; programi vjetor për punë I shkollës; program për punë të shërbimit profesional.

6.4 Përcjellja e nevojave zhvillimore të kuadrit arsimor

Tema:

- Zhvillimi profesional i mësime dhënëse

Në arsimin fillor në periudhën e kaluar është bërë një përparim i konsiderueshëm me zmadhimin e nivelit të arsimit klasor dhe lëndor në ç'rast edhe kuadri i jonë arsimor me vëmendje të veçantë përcjell novitetet dhe ndryshimet në çdo fushë mësimore dhe të njëjtat i aplikon në praktikë. E njëjta vlen edhe për drejtorin dhe bashkpunëtorët profesional të cilët në kontinuitet i përcjellin dhe i pranojnë novitetet dhe ndryshimet në detyrat e tyre dhe ato të mësime dhënëse. Theks i veçant i jepet aplikimit të formave dhe metodave të reja nga ana e mësime dhënëse me çka të mundësohet procesi edukativo-arsimor të përputhet me aftësitë individuale dhe karakteristikat zhvillimore të nxënësve. Me profesionalizimin pedagogjik të mësime dhënëse mundësohet realizim i suksesshëm i përmbajtjeve të reja mësimore të përfshirë në programet mësimore dhe librat si rezultat i ndryshimeve, shoqërore ,zhvillimit teknologjik, arritjeve të reja në shkencë. Në shkollë kjo filloi të realizohet nga viti i kaluar me përpunimin e planifikimit tematiko – vjetor në formë elektronike, kurse prej një kohe më të gjatë përpunohen

dokumentacionet e nxënësve, dëftesat, vërtetimet, lutjet, dosiet, planet për aktivin profesional etj. Me kontinuitet funksionojnë edhe ditarët elektronik çka mundëson që prindërit të kenë qasje në suksesin e fëmijve të tyre. Njëkohësisht mundëson që shkolla jonë më lehtë të jetë në kontakt me institucionet tjera, përfaqësuesit e vetqeverisjes lokale, komunën, me prindërit etj.

Burimi I të dhënave

Biseda me shërbimin profesional, mësimdhënësit dhe drejtorin, program për zhvillimin profesional të kuadrit arsimor, raport nga vetevaluimi, program për punën e mentorit dhe të punësuarit të ri gjat vitit shkollor.

6.5 Puna finansiare në shkollë

Tema:

- Procedurat me të cilat respektohet regullativa ligjore për punën finansiare
- Transparencë në planifikimin dhe harxhimin e buxhetit të shkollës .

Procedurat e punës finansiare që i kryen shkolla janë në pajtueshmëri me normat ligjore. Kuadri udhëheqës il njuh dhe kupton mekanizmat që mund ti përdorë për grumbullim të mjeteve finansiare shtesë. Në Komitetet për prokurim publik detyrueshëm ka anëtar nga këshilli I shkollës dhe I njejt i regullisht ndjek shpenzimin e buxhetit me qëllim të përfitoj përmisimin e kualitetit të mjeteve finansiare të harxhuara.

Shkolla i informon të gjitha organet e shkollës për buxhetin dhe shpenzimin e të njejt i. Personat përgjegjës regullisht diskutojnë për informatat në lidhje me resurset dhe nëpërmjet vendimeve që i marrin sigurojn ekonomizim, efektivitet dhe drejtësi në shpërndarjen e mjeteve finansiare. Kuadri udhëheqës konsultohet me shumicën e të punësuarve kur është nevoja edhe në detaje dhe nivel përkatës. Prioritetet buxhetore janë ngushtë të lidhura me prioritetet dhe qëllimet arsimore të shkollës. Buxheti harxhohet në mënyrë të përfillt dhe për qëllime kreative që fokusohen në përmisimin e kualitetit të mësimi dhe mësimnxënies dhe zhvillimit të shkollës në përgjithësi.

Burimi I të dhënave

Plani financiar ;plani zhvillimor dhe program vjetor I punës;bisedë me drejtorin; procesverbalet dhe vendimet e këshillit të shkollës;kontratat e arritura; tenderet ; ofertat ; procesverbalet nga revizioni I AHP.

Rezultatet

Përparsitë

- Bashkpunim dhe komunikim I mirëfillt ndëretnik I të punësuarve
- Kushte të mira për punë në shkollat periferike ndërsa në atë qendrore janë edhe më të mira me atë që ka klasë përkatëse për mbajtjen e orës TIK.

Dobësit

- Implementim jo i plotë i aktiveve profesionale
- Bashkpunim jo I mjaftueshëm me prindërit
- Klasa jopërkatëse për realizimin e mësimit
- Mungesë të mjeteve mësimore dhe ndihmëse në disa lëndë.
- Mungesë të mësimit kabinetik
- Mungesë të pajisjeve teknike nëpër klasa
- Kulme ,dritaret,dyert dhe dyshemet joadekuate në shkollen qendrore
- Mungesë të bibliotekës
- Mungesë të sallës së sportit

Analiza e rezultateve

Në shkollën tonë ka një shkollë qendrore dhe dy periferike .Mësimi në shkollën qendrore dhe ato periferike mësimi zhvillohet ne gjuhën shqipe.Punohet në dy ndryesore në përjashtim të periferikut në Paniçarë ku mësimi zhvillohet vetëm në ndryesoren e parë.Në aspekt të hapsirave dhe furnizimit me mjete dhe materiale mësimore nuk i përmbush nevojat e duhura për mbajtje të mësimit.Biblioteka e shkollës ka fond të librave që pjesërisht përmbush rrjedhat bashkohore te materialeve. Në shkollë janë të punësuar 48 mësimdhënës . Punën e tyre të përditshme e ndjek drejtori dhe pedagogu i shkollës me kontakte dhe biseda të përditshme. Në shkollë punohet në mënyre ekipore dhe ndjekën vazhdimisht ndryshimet.

Aktivite të ardhshme

- Sigurim i mësimit kabinetik
- Sigurim të mjaftueshëm të mjeteve dhe materialeve mësimore
- Rritjen e numrit të klasave
- Sigurim të rrjetit të internetit në shkollat periferike

Antarët e timit:

1. Ilirjana Selimi
2. Rahime Sali
3. Gjilfije Ziberi

Fusha 7.Udhëheqja.menaxhimi dhe krijimi I politikës

Nr.Treguesi I cilësisë

7.1 Udhëheqja dhe menaxhimi I shkollës

7.2 Qëllimet dhe krijimet e politikës së shkollës

7.3 Planifikimi zhvillimor

Temat

- Udhëheqja e shkollës
- Menaxhimi i shkollës

- Qëllimet e qarta dhe adekuate
- Procedurat për krijimin e politikës shkollore

- Qëllimet e planifikimit zhvillimor
- Zhvillimi profesional / trajnimi profesional i kuadrit
- Mjetet materiale dhe teknike
- Infrastruktura

7.1 Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollës

Temat:

- Udhëheqja e shkollës
- Menaxhimi I shkollës

Shkollën tonë e përbëjnë këto struktura:

1. Këshilli i shkollës si organ udhëheqës të cilin e përbëjnë 7 anëtarë.
2. Drejtori udhëheqës(menaxhues)
3. Këshilli i arsimtarëve
4. Kolegiumi arsimor
5. Aktivitetet profesionale
6. Këshilli i prindërve
7. Organi profesional-Pedagog-Psikolog

Në ligjin për arsimin fillor dhe statutit të shkollës, qartë janë të definuara obligimet dhe detyrat e strukturave udhëheqëse në shkollën tone.

Këshilli i shkollës është organ i cili qeveris me shkollën në të gjitha segmentet siç janë :vizionin për shkollën,zgjedhjen e kuadrit, mbikqyrjen financiare, përcjelljen e cilësisë dhe notimin, përcjelljen e mirëqënjes së nxënësve në shkollë si dhe raporte korekte me pushtetin qendror dhe lokal.Për nga struktura e tij këshilli i shkollës është organ kolegial që do të thotë se përbëhet nga më shumë anëtarë.Numri i anëtarëve të këshillit të shkollës dhe struktura e tij rregullohen me ligj.

Këshilli i shkollës tonë përbëhet prej 7 anëtarëve edhe ate: 3 përfaqësues të prindërve

3 përfaqësues të arsimtarëve

1 përfaqësues nga komuna

Mbledhjet mbahen në pajtim me rregulloren e punës së këshillit shkollor. Këshilli shkollor u siguron informata të hollësishme dhe të gjithanshme për punën e vet, të gjitha subjekteve të kyçura në procesin edukativo – arsimor. Këshilli I shkollës ka vendosur marrdhënie partneriteti me organin udhëheqës të shkollës (drejtorin) dhe me strukturat tjera arsimore. Organi udhëheqës i shkollës ka njohuri se në çfarë mënyre objektivisht ti vlersojë cilësitë e të punësuarve dhe kontributin e tyre në punën ekipore dhe si ta promovojë praktikën e mire që ekziston në shkollë. Sjellë vendime përgjegjëse, merrë iniciativa dhe menaxhon suksesshëm me ndryshimet në sistemin arsimor. Identifikon dhe fokusohet në prioritete të qarta që janë identifikuar në planin zhvillimor përmes evaulimit personal efektiv, kurse në qendër të punës së vet i vendos arritjet e nxënësve dhe përmirsimin e pasqyrës shkollore. Mbledhjet e këshillit të klasave dhe kolegiumit arsimor i njoftonë drejtori i shkollës me anë të lajmërimit në tabelën e lajmërimeve edhe atë me rend dite të përpiluar para mbledhjes, i cili mund të plotësohet nga ana e këshillit apo kolegiumit arsimor. Mbledhjet organizohen varësisht nevojave të shkollës. Edhe shkollat periferike si ajo e f.Laskarc dhe f.Panicar lajmërohen përmes përgjegjësve të atyre shkollave. Të gjitha organet në shkollën tone funksionojnë në lidhshmëri me njëra tjetrën siç janë. Drejtori bashkëpunon me këshillin e shkollës dhe pastaj për raste të ndryshme njoftohen arsimtarët nëpërmjet organeve të tyre si ai i kolegiumit dhe këshillit të klasave, ndërsa këta në takime me prindërit në mbledhjet e organizuara prindore i informojnë ata. Prindërit mendimet apo propozimet e tyre i drejtojnë tek këshilli i prindërve. Nxënësit informohen nëpërmjet kujdestarëve të klasave. Rol të posacëm në zhvillimin e procesit edukativo- arsimor ka edhe bashkëpunimi i drejtorit me shërbimin profesional të shkollës dhe me trupin arsimor, i cili bashkëpunim realizohet me takime individuale apo edhe me mbledhjet e organizuara të kolegiumit apo këshillit të klasave. Si drejtori po ashtu edhe shërbimi profesional i shkollës kanë

program vjetor për punën e tyre, ndërsa strukturat tjera shkollore kanë rregullore për punën e tyre.
 Shkolla qendrore ndodhet në f.Bojan në të cilën zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe edhe atë prej klasës së pare deri në klasën e nëntë. Shkolla punon me dy ndërrime
 Në shkollën periferike të f.Llaskarc mësimi zhvillohet në gjuhë shqipe prej KL.I-IX. Punohet në dy ndrime.
 Shkolla periferike e f.Panicar – mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe edhe atë prej KL.I-IX. Në këtë shkollë punohet vetëm në një ndrim.

Burimet

Rregullorja për punën e këshillit shkollor, Statuti i shkollës, Proçesverbalet, vendimet dhe raportet nga këshilli i shkollës plani zhvillimor programi për punën e drejtorit,,Programi për zhvillimin profesional të drejtorit, intervistë me anëtarët e këshillit të shkollës, intervistë me mësime dhënësit, prindërit, nxënësit etj.

7.2 Qëllimet dhe krijimi i politikës shkollore

Temat:

- Qëllimet e qarta dhe adekuate
- Procedurat për krijimin e politikës së shkollës

Qëllimet e shkollës janë në përputhje me qëllimet e politikës arsimore shtetërore dhe lokale. Qëllimet janë të qarta dhe janë të fokusuara në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe arritjes maksimale të gjithë nxënësve. Për krijimin e politikës shkollore bazë meret statusi i shkollës, ndërsa planifikohet në programën shkollore . Në krijimin e politikës shkollore marrin pjesë drejtori i shkollës, shërbimi profesional mësime dhënësit dhe

merret parasysh fakti se cila është më primarja dhe duhet ti kushtohet më tepër vëmendje. Sa i përket politikës shkollore njoftohet këshilli i shkollës ,ku me anë të votimit lejon realizimin e saj. Në bazë të programës shkollore dhe aktiveve tjera të shkollës u jepet përkrahja nxënësve për avansim në nivelin shëndetsor ,zgjidhja e konflikteve apo problemeve të tjera. Gjatë vitit shkollor bëjmë kontrollimin sistematik të nxënësve nga ana e mjekëve në qendrën poliklinike Simpo dhe poliklinika Bukuresht-Karposh. Kjo vizitë bëhet me plan të realizuar nga ana e poliklinikës në fjalë. Nxënësit e shkollës sonë pranojnë vaksina të parapara me plan nga ana e poliklinikës Simpo. Nga vullunteret e kryqit të kuq mbahen ligjerata me nxënësit e klasave të teta dhe nënda në lidhje me drogën ,alkoholin, dhe duhanin. Sa i përket shëndetit të nxënësve kujdes të veçantë u japin në orët e kujdestarisë shkathtësive jetësore. Sa i përket aftësive të nxënësve shkolla jonë bën testimin e tyre edhe atë gjatë regjistrimit të nxënësve në KL. I testim që është i përgatitur nga ana e pedagoges të shkollës si dhe me vërtetimit mjeksor I marrun nga mjeku amë ata regjistrohen si nxënës të rregullt. Nga rezultati i këti testimi njoftohen arsimtarët në lidhje me çdo nxënës dhe nga ana e arsimtarëve gjatë vitit shkollorë përcjelllet çdo nxënës në lidhje me ngecjen apo avansimin e tyre. Arsimtarët njoftohen me aftësitë psiko fizike dhe shëndetsore të nxënësve. Nga ana e arsimtarëve organizohen orë shtuese dhe plotësuese si dhe aktivitete të lira të nxënësve. Në shkollën tone nxënësit përgatiten për gara të ndryshme të diturisë si ajo :Olimpiada e diturisë , që organizohet nga komuna e Sarajit në nivel komunal dhe brenda shkollës sonë. Sa i përket gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi në shkollën tone është e rregulluar në bazë të ligjit për arsimin fillor të R.M. Në shkollën tone mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe maqedonase. Nxënësit mësojnë edhe tre gjuhë të huaja, gjuhën angleze që zhvillohet prej KL. I-IX,

gjuha frenge që zhvillohet prej KL.VII si dhe gjuha gjermane që zhvillohet prej kl.VI.

Shkolla planifikon dhe me kohë mundëson materiale harxhuese në numër të konsiderueshëm për realizimin e mësimit dhe aktiviteteve jashtë mësimore në pajtueshmëri me planin shkollor.

Burimet e të dhënave

Programi vjetor për punën e shkollës, anketat gojore me drejtorin shërbimin profesional , mësime dhënësit, prindërit dhe nxënësit ,procesverbalet nga Këshilli shkollor, Këshilli prindëror, Këshilli arsimor, dhe aktet interne.

6.3 Planifikimi zhvillimor

Temat:

- Qëllimet e planifikimit zhvillimor
- Zhvillimi professional/ trajnimi profesional i kuadrit
- Mjetet materiale dhe teknike

Qëllimet janë precize të qarta dhe e reflektojnë misionin dhe vizionin e shkollës. Gjatë përcaktimit të qëllimeve inkuadrohen mësime dhënësit, prindërit nxënësit dhe përfaqësuesit e bashkësisë lokale. Shkolla ka plan për ndjekjen e suksesit të nxënësve që e realizon 4 herë brenda një viti shkollor edhe ate përgatit raporte sa i përket suksesit të nxënësve ,në tremujorshin e parë,në gjysëmvetorin e parë,në tremujorshin e dytë dhe në fund të vitit shkollor me anë të raportit

- Infrastruktura

tekstual dhe statistikor. Shkolla i merr parasysh qëndrimet e mësimeve, prindërve dhe bashkësisë lokale. Nga kjo shihet se shkolla me kohë vazhdimisht i identifikon nevojat për trajnim profesional të kuadrit. Në arsimin fillor në periudhën e kaluar është bërë një përparim i madh në kualifikimin e kuadrit arsimor po ashtu edhe në shkollën tonë si në atë të arsimimit klasor dhe lëndor. Kuadri arsimor i shkollës mundohen të përcjellin risitë dhe ndryshimet në të gjitha fushat arsimore dhe i praktikojnë në punën e tyre të përditshme përmes seminareve të ndryshme që i organizon Byroja për Zhvillimin e Arsimit si dhe MASH-ës. E njëjta vlen edhe për drejtorinë dhe shërbimin profesional të shkollës, të cilët çdo here i përcjellin dhe i pranojnë ndryshimet me kujdes i praktikojnë në punët e tyre të përditshme. Rëndësi të veçantë u kushtohet formave dhe metodave të reja të punës si dhe mësimit interaktiv gjatë orës mësimore që duhet të përdorin mësuesit në procesin edukativo-arsimor. Sa i përket trajnimit profesional të kuadrit arsimor mund të themi se shkolla jonë është kycur në disa projekte: Modernizimi i arsimit, Projekti ndëretnik në arsim, në ITK projektin, Notimi sumativ, Notimi formative, si dhe në projektin e USAID-it PEP, certifikimi i mësimeve trajnimi i mësimeve të lëndëve shkencorë-natyrore.

Nga i gjithë ky trajnim profesional i mësimeve lirisht mund të themi se shumica e mësimeve përdorin metoda dhe forma të reja në procesin edukativo-arsimor. Shkolla jonë nuk është përfshirë në trajnimin e mësimeve për punë me nxënës që kanë nevoja të veçanta.

Shkolla jonë ka një numër të konsiderueshëm të kompjuterëve, projektorëve dhe printerëve si dhe mjeteve tjera mësimore që ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e procesit-edukativo arsimor.

Shkolla i identifikon me kohë nevojat për mjete materiale dhe teknike dhe vazhdimisht i planifikon dhe i siguron ato. Shkolla planifikon dhe siguron mjete për mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre. Ndodh që shkolla përveç që siguron mjete nga MASH-së, sigurojnë mjete edhe nga donatorë të ndryshëm si nga ana e prindërve biznesmenëve të ndryshëm dhe nga organizatat e huaja jo qeveritare etj. Nga kjo del se shkolla jonë bashkëpunon me bashkësinë lokale, organizatat e ndryshme qeveritare dhe jo qeveritare dhe prindërit sa i përket përmirimit të infrastruktures së shkollës.

Burimet e të dhënave

Plani zhvillimor i shkollës, procesverbalet nga organet dhe trupat shkollore, intervista gojore me drejtorin mësimdhënës, prindërit nxënësit dhe anëtarët e këshillit të shkollës, plani financiar i shkollës Qasje në paisjen dhe infrastrukturën e shkollës, aplikacione të shkollës për sigurimin e mjeteve nga vetëqeverisja lokale, donatorët e ndryshëm.

Rezultatet

Përparsitë

- Bashkëpunimi dhe komunikimi ndëretnik në kolektivin tone.
- Kushte të volitshme për punë.
- Bashkëpunimi me prindërit.
- Bashkëpunimi me organizata qeveritare dhe jo qeveritare si dhe me donatorë të

Dobësitë

- Aktivitetet profesionale nuk funksionojnë sa duhet nuk ka një koordinim të mirëfilltë.
- Mësimi zhvillohet nga ana e arsimtarëve ende në mënyrë klasike ku qendër e vëmendjes është arsimtari e jo nxënësi.
- Në shkollën tonë nuk ka kushte për zhvillim të mësimin kabinetik.
- Planet aksionare
- Plani i ndjekjes dhe evaluimit të realizimit të planeve aksionare.
- Puna ekipore mungon.
- Trajnimi profesional i kuadrit.

ndryshëm.

- Bashkëpunimi me vetëqeverisjen lokale

Përfundim

Analiza e rezultateve

Një numër i madhë i kuadrit arsimor janë të rikualifikuar,poashtu janë kyçur në projekte të ndryshme të shkollës si të asaj të USAID-it PEP projekti, modernizimi i arsimit etj, Projekti ndëretnik në arsim.

Shkolla vazhdimisht e revidon planin për përmirsimin dhe modernizimin e infrastrukturës së shkollës dhe siguron mjete nga donatorë të ndryshëm dhe Komuna.Në shkollën tone ka klimë për punë dhe bashkëpunimi është në nivel edhe në baza etnike dhe fetare.

Aktivitete në të ardhmen që do të kyçen në planin zhvillimor të shkollës

- Të krijohen kushte për mësim vetëm me një ndrim.
- Shkolla qendrore të krijon kushte për mësim kabinetik
- Të hapen paralele tërditore deri në kl.V.
- Shkolla të ketë menzë për ushqim të shendetshëm të fëmijve.

- Angazhimi dhe kycja e kuadrit arsimor në projekte të ndryshme që kanë rëndësi të madhe në realizimin e procesit edukativo-arsimor.
- Sigurimi i mjeteve mësimore
- Të krijojmë kushte për mësojtore të tjera , meqë në shkollën tonë dhe periferike ka mungesë.
- Aktivitete tjera ndërtimore që ka nevojë shkolla jonë.
- Rregullimi i kopshtit të shkollës

Antarët e timit:

1. Bari Mamuti-Drejtor (nga muaji shkurt 2022 Lulzim Mustafa)
2. Arjeta Murati-Sekretar
3. Metush Sali- Arkatarë